


	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	ver. 1.0	faqe 1 nga 96
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti


OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
 OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZISTA KOSTT d.d
 Nr. 176/A dt. 15-03-2012
 PRISHTINE-A


KOSTT

Raport Vjetor 2011

(01.01.2011-31.12.2011)


	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Shpresa Kursani	Fadil Ismajli KSHE	J. d. Kryesuesi i BD Rajmëdan Paçarada
Nënshkrimi			
Data	Shkurt, 2012		




	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 96</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Raport Vjetor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT
Periudha Janar - Dhjetor 2011

1	Titulli i Dokumentit	Raport Vjetor 2011
2	Dërguesi i dokumentit	Fadil Ismajli, Kryeshef Ekzekutiv
3	Përmbajtja e Raportit	<p>Përmbajtja Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT</p> <p>1. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve 1.1. Aktivitete kryesore të ndërmara gjatë vitit 1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja 1.3. Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv 1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual 1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it 1.6. Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm 1.7. Infomacionet lidhur me kapitalin dhe dividendën 1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit</p> <p>2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv 2.1. Arritjet kryesore 2.2. Ngjarjet kryesore të vitit 2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës 2.3.1. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për Janar-Dhjetor 2011 2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës – operimi i sistemit 2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit 2.3.4. Operimi i tregut 2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet 2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare 2.4. Progresi me planin e biznesit 2.5. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT</p>

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

		<p>2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm</p> <p>2.7. Rreziqet</p> <p>Anekset</p> <p>1. Sponzorimet dhe donacionet</p> <p>2. Raporti i Auditorit të Brendshëm</p> <p>3. Formulari i Vetëvlerësimit të Bordit</p> <p>4. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike</p> <p>4.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit</p> <p>4.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore</p> <p>4.3. Kontratat/transakcionet e konsiderueshme gjatë vitit 2011 nga burimet e KOSTT</p> <p>4.4. Sugjerime dhe propozime për rritjen e performancës</p> <p>Lista e shkurtesave</p>
4	Data e Raportimit	

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Hyrje

Raporti Vjetor i vitit 2011 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ku brenda 45 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport vjetor i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, ky Raport do të dërgohet te Njësia për Politikën dhe Monitorimin të NP-ve.

Ky Raport është punuar sipas formës së re të aprovuar nga Njësia për Politikën dhe Monitorimin të Ndërmarrjeve Publike dhe sipas “Udhëzuesit për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjes Publike”.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2011 si dhe të aktiviteteve krahasuar me Planin e Biznesit, planin vjetor dhe shkallën e realizimit, respektivisht, implementimin e Planit të Biznesit.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të KOSTT-it


Bordi i Drejtorëve si organ i pavarur i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës ka për detyrë që nëpërmjet përcaktimit të politikave afariste dhe udhëzimit strategjik të ruaj dhe rrisë vlerën e kompanisë në dobi të aksionarit, në këtë rast Republikës së Kosovës. Në funksion të kësaj detyre primare ka qenë e drejtuar edhe puna e Bordit.

Gjatë vitit 2011 KOSTT ka shënuar një progres shumë të rëndësishëm si në përmirësimin e shërbimeve të veta në ofrimin e një rrjeti transmetues të besueshëm dhe kapaciteteve të mjaftueshme transmetuese për klientët e vetë, që do të thotë se kapacitetet transmetuese janë rritur ndjeshëm në karahsim me vitet paraprake. Kjo gjithashtu është shoqëruar me rritje të nivelit të sigurisë së operimit. Këto përmirësime janë mundësuar me implementimin e projekteve investive në KOSTT, që janë implementuar me një mbikqyrje të mirëfilltë nga menaxhmenti i KOSTT-it dhe Bordi i Drejtorëve. Kjo dëshmohet me raportin e auditorit të pavarur pa asnjë kualifikim, e që në masë të konsiderueshme lehtëson punën e Bordit dhe rritë besimin e aksionarit se KOSTT është në rrugë të mirë. Edhe gjatë vitit 2011 KOSTT është dëshmuar si punëdhënës atraktiv i cili me angazhime të shumta ka arritur të krijojë një ambient për investimin në zhvillimin profesional të punëtorëve dhe t'i motivojë në arritjen e performancës së standardeve më të larta.

Vlen të theksohet se Bordi gjatë periudhës raportuese ka pasë mbështetje të plotë nga zyrtarët dhe menaxhmenti profesional i KOSTT-it dhe do të vazhdojë të përkrahë atë në implementimin e projekteve madhore në të ardhmen, dhe përmbushjen e objektivave për inkuadrim të plotë në strukturat rajonale dhe evropiane të sektorit të transmisionit.

Si edhe deri më tani, do të vazhdojmë me ndërtimin dhe zhvillimin e raporteve korrekte, në rradhë të parë me aksionarin tonë (Qeverinë e Kosovës), me palët e interesit posaçërisht me ZRrE, donatorët (Komisioni Evropian, KfW,USAID, etj), OST-të fqinje dhe më gjërë,me shfrytëzuesit e shërbimeve të transmisionit por edhe me institucionet financiare relevante vendore e ndërkombëtare.

Sinqerisht,
 Ramadan Paçarada
 U.d. Kryesues i Bordit të Drejtorëve të KOSTT sh.a.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 6 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT

Viti 2011 për KOSTT shënon edhe një vit të suksesshëm të ushtrimit të aktivitetit të pavarur si operator sistemi, transmissioni dhe tregu të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës.

Arritjet e KOSTT-it janë rezultat i angazhimit të mirëfilltë të të gjithë punëtorëve dhe ekipit menaxherial, por që u kurorëzuan me sukses falë mbështetjes institucionale dhe financiare nga aksionari dhe palët e interesit, si dhe një qeverisjeje profesionale korporative nga ana e Bordit të Drejtorëve.


Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmissioinit është një ndër detyrat kryesore të KOSTT. Në këtë drejtim, angazhimi profesional nga ana e punonjësve në një anë dhe investimet në rritjen e kapaciteteve të transmissioinit, modernizimi i sistemit dhe mirëmbajtja preventive, nga ana tjetër, kanë ndikuar në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit gjë që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

Gjatë vitit 2011, janë realizuar projekte të rëndësishme të cilat kanë kontribuar në përmbushjen e kësaj detyre. Janë ndërmarrë shumë aktivitete në implementimin e projekteve të reja dhe përfundimin e projekteve në vazhdim, gjë që do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të vendosura nga KOSTT, të cilat janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat teknike që dalin nga ENTSO-E.

Performanca e operimit të sistemit të transmissioinit gjatë vitit 2011 ka pasur ngritje të theksuar. Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmissioinit rregullisht kanë qenë më të vogla se ato të planifikuarat ndërsa numri i ankesave për kualitet të tensionit dhe energjia e pafurnizuar në krahasim me vitin paraprak, janë zvogëluar dukshëm. Tërë kjo, është përcjellur edhe me zhvillimin e infrastrukturës fizike ligjore dhe rregullative.

Të arriturat e numëruara më lartë lidhen me avancimin e Sigurisë së Sistemit elektroenergjetik, e që për KOSTT është dhe mbetet objektivi kryesor. Apo, siç thotë Presidenti i NYISO (New York Independent System Operator) “...siguria nuk është aksidentale. Ajo është rezultat i planifikimit të kujdesshëm të burimeve, trajnimit të një shkalle të lartë të operatorëve dhe një vigjilencë konstante çdo ditë, orë për orë, vit pas viti”

Për më tepër, KOSTT ka vazhduar angazhimin dhe përgatitjet për të mbështetur projektet për privatizimin e KEK Shpërndarjes dhe Furnizimit dhe projektin për termocentralin Kosova e Re. Poashtu, mbetet i zotuar për ofrimin e qasjes së

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

barabartë në rrjet për të gjithë përdoruesit e sistemit, si dhe mbështetjen e energjisë nga burimet e ripërtrishme, në bazë të rregullave të miratuara nga ZRrE.

Gjatë vitit 2011, për të pestën herë rradhazi, raporti i auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare të KOSTT për vitin 2010 janë marrë pa asnjë kualifikim, që reflekton punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të të gjitha resurseve të KOSTT.

Padyshim, që në mesin e të arrijturave është edhe rezultati i parë nga ankesa e KOSTT ushtruar pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vjenë kundër Serbisë. Bëhet fjalë për pengesat dhe obstrukcionet e vazhdueshme në aspektin e tregtimit ndërkufitar që vjen nga operatori homolog i Serbisë, e që ka marrë rrugën e zgjidhjes, me që nga ana e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë i është dërguar Republikës së Serbisë dhe është publikuar dokumenti me emrin “Mendimi i arsyeshëm”. Në këtë dokument konstatohet se Serbia është duke vepruar në kundërshtim të plotë me Traktatin e Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore, si dhe me provizionet e “*acquis communautaire*” për energji, ndërsa KOSTT-it i njihet e drejta për tranzit dhe alokim të kapaciteteve të interkonjeksionit. Nga Serbia kërkohet që të rikuperoj gjendjen dhe të hjekë dorë nga pengesat që bën ndaj KOSTT-it.


KOSTT ka vazhduar të dëshmojë përpikëri në zbatimin e standardeve më të larta organizative profesionale që dëshmohet me certifikimin për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008. Me këtë, KOSTT bëhet ndërmarrja e parë publike në Kosovë, e certifikuar me këtë standard.

KOSTT është e vetmja kompani publike të cilës Oda Ekonomike Amerikane dhe UNDP i ndanë mirënjohje për Përgjegjësi Shoqërore të Korporatave (CSR).

KOSTT është dhe mbetet edhe më tutje i përkushtuar për të dhënë kontributin e vet në përshejtimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Kosovës, në ruajtjen dhe krijimin e vlerave të reja në sistemin elektroenergjetik dhe në dobi të vendit.

Përpjekjet tona të vazhdueshme, do të jenë të orientuara drejt përmbushjes së synimeve tona shumë qartë të përcaktuara, zhvillimit dhe punës tonë dhe përgatitjes për një të ardhme të dimensionit evropian.

Kryeshafi Ekzekutiv:
Fadil Ismajli

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve

1.1. Aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2011 KOSTT-i ka zhvilluar aktivitete të ndryshme të qeverisjes korporative bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Aktivitete kryesore në këtë aspekt përfshijnë aktivitetet e Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera që Bordi i ka themeluar për nevojat e KOSTT-it.

Procesverbalet nga mbledhjet e Bordit, të Komisionit të Auditimit dhe të Komisioneve të tjera, raportimi dhe dërgimi i infomatave Njesisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) siç kërkohen sipas nenit 31, 32 dhe 37 të Ligjit për NP, janë kryer në mënyrë të rregullt dhe sipas afateve ligjore. Gjatë vitit 2011 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka mbajtur gjithësejt 10 mbledhje.

Çdo mbledhje e rregullt e Bordit ka trajtuar disa pika që paraqiten si pika të zakonshme dhe përfshijnë: Vërtetimin e kuorumit dhe aprovimin e rendit të ditës nga mbledhja paraprake e Bordit të Drejtorëve, Shqyrtimin e Raportit të Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera dhe Informatën rreth aktiviteteve nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv (KE) të KOSTT-it.

Në çdo mbledhje Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e Komisionit të auditimit dhe rekomandimet si dhe procesverbalet e Komisioneve të tjera siç janë: Komisioni i Projekteve kapitale, Komisioni i ndërtimit të linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri dhe Komisioni për ndarjen e aseteve KEK-KOSTT.


Raportet nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të themeluara nga Bordi janë prezantuar si materiale në mbledhjet e Bordit dhe janë dërguar në NJPMNP.

Gjatë vitit 2011 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka mbajtur 10 mbledhje:

- 7 (shtatë) mbledhje të rregullta
- 2 (dy) mbledhje të jashtëzakonshme
- 1 (një) mbledhje për vlerësimin e Bordit


Mbledhjet e Bordit janë vijuar nga të gjithë Drejtorët përveç në një mbledhje kemi pasë mungesë të një anëtari për shkak të sëmurjes, përndryshe vijimi i mbledhjeve ka qenë i kënaqshëm nga të gjithë anëtarët e Bordit.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur vendimet kryesore që janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2011 duke mos i përfshirë mbledhjet dhe konsultimet e Zyrtarëve të Kompanisë, respektivisht Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit Kryesor

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 9 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Financiar, Sekretarit të Kompanisë dhe Auditorit të Brendshëm me Bordin dhe Zyrtarët e Njësisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike, raportimet dhe aktivitetet e ngjashme korporative.

Nr.	Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon:
1	Raport tremujor për periudhën Janar –Mars 2011, Raport tremujor për periudhën Prill – Qershor 2011, Raport tremujor për periudhën Korrik-Shtator 2011 dhe Raport tremujor për periudhën Tetor-Dhjetor 2011 (bazuar në nenin 31 të Ligjit për NP)
2	Manuali Financiar i modifikuar
3	Raporti i Komisionit për regjistrimin e pasurisë të KOSTT-it për vitin 2010 (Elaborati i regjistrimit të asetëve)
4	Plani i punës së Bordit të Drejtorëve (BtD) dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2011
5	Raporti Vjetor i punës së KOSTT-it për vitin 2010
6	Ndryshimet në Makro Skemën Organizative të KOSTT-it
7	Politika për shfrytëzimin e telefonave mobil
8	Politika për praktikën profesionale në KOSTT
9	Pasqyrat financiare dhe Buxheti për vitin 2011 i reviduar pas aprovimit të tarifave nga ZRrE -me 1 prill 2011
10	Politika për dosjet personale të punëtorëve
11	Vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore shtesë për furnizimin dhe instalimin e OPGW (96 fibra) në Linjën e dyfishtë 110 kV që furnizon NS 110/10 (20) kV- Gjilani 5
12	Manuali i Sistemin të Menaxhimit të Cilësisë (plotësimet dhe ndryshimet)
13	Politika e Rekrutimit dhe Selektimit(plotësimet dhe ndryshimet konform Ligjit të punës)
14	Politika e pushimeve (plotësimet dhe ndryshimet konform Ligjit të punës)


	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

15	Politika mbi orarin e punës (plotësimet dhe ndryshimet konform Ligjit të punës)
16	Kodi Disiplinor (plotësimet dhe ndryshimet konform Ligjit të punës)
17	Plani i Prokurimit për vitin 2012
18	Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare rregullative për vitin 2010
19	Raporti mbi auditimin e brendshëm të punës së zyrës së prokurimit në KOSTT
20	Raporti mbi Përmbushjen e Nevojave të Konsumatorëve për vitin 2011
21	Plani i Biznesit të KOSTT-it për vitin 2012
22	Buxheti për vitin 2012
23	Vendimi për lejimin e blerjes së një poli të ndërprerësit 400kV nga ana e KOSTT-it
24	Letra e menaxhmentit për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2010
25	Raporti për rezultatet financiare dhe performancën e KOSTT-it gjatë periudhës shtator-dhjetor 2011
26	Politika mbi nivelin e autorizimeve në KOSTT (plotësimet dhe ndryshimet)
27	Politika për shfrytëzimin e telefonave mobil (plotësimet dhe ndryshimet)

1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja

Gjatë vitit 2011 Komisioni i Auditimit ka vlerësuar të gjitha raportet tremujore, raportin vjetor të vitit 2010, raportin e auditorit të jashtëm në KOSTT, raportet e auditorit të brendshëm, propozim Buxhetin për vitin 2011, Planin e Biznesit për vitin 2011, politikat, Planin e Auditimit të Brendshëm për vitin 2011, Planin e prokurimit dhe raporte të tjera.

Komisioni i Auditimit ka mbajtur 7 (shtatë) mbledhje.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Komisioni për projektet kapitale i themeluar nga Bordi për nevojat e KOSTT-it ka mbajtur 3 (tri) mbledhje. Komisioni për projekte kapitale përbëhet nga 3 Drejtorët e Bordit të cilët asistohen nga Drejtori i Departamentit për Menaxhim dhe Inxhinieri të Projekteve të KOSTT-it.

Komisioni për ndarjen e aseteve KOSTT-KEK i themeluar nga Bordi ka mbajtur 2 (dy) mbledhje. Ky komision përbëhet nga 2 Drejtorët e Bordit të cilët asistohen nga Menaxheri i Departamentit për Menaxhim dhe Inxhinieri të Projekteve dhe stafi i KOSTT-it.

Komisioni për linjën 400 kV Kosovë- Shqipëri ka mbajtur 2 (dy) mbledhje. Komisioni për projekte kapitale përbëhet nga 2 Drejtorët e Bordit të cilët asistohen nga Zv.Kryeshefi Ekzekutiv për Zhvillim.

Drejtorët e Bordit në KOSTT në vazhdimësi kanë qenë në komunikim dhe bashkëveprim me menaxhmentin e KOSTT-it, që ka rezultuar me efikasitet më të madhe në marrjen e vendimeve të nevojshme.

1.3. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv

Gjatë vitit 2011 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka qenë në përbërje si vijon:


Ramandan Paçarada, (u.d) Kryetar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it (Anëtar i Komitetit të Auditimit, Kryetar i Komisionit për projektet Kapitale dhe anëtar i Komisionit për ndarjen e aseteve KEK-KOSTT), me profesion: ekonomist
Paga bazë për vitin 2011: neto 5,130.00 Euro

Faton Deda, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it dhe anëtar i Komisionit të Bordit për Linjën 400 kV Kosovë-Shqipëri, me profesion: inxhinier
Paga bazë për vitin 2011: neto 4,104.00 Euro

Fatos Uka, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it (gjithashtu Kryetar i Komitetit të Auditimit, anëtar i Komisionit të Bordit për Linjën 400 kV Kosovë-Shqipëri, me profesion: profesor universitar
Paga bazë për vitin 2011: neto 4,104.00 Euro

Lutfi Maxhuni, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it dhe Anëtar i Komisionit të Bordit për Projektet Kapitale, me profesion: ekonomist
Paga bazë për vitin 2011: neto 4,104.00 Euro

Nazmi Mikullovc, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, Kryetar i Komisionit të Bordit për Linjën 400 kV Kosovë-Shqipëri, Anëtar i Komisionit të Bordit për

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 96</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

projekte Kapitale dhe Anëtar i Komisionit të Bordit për ndarjen e asteve KEK-KOSTT), me profesion: inxhinier
Paga bazë për vitin 2011: neto 4,104.00 Euro

1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual

Performanca Operative dhe financiare e KOSTT-it gjatë vitit 2011 është mjaft e mirë dhe tregon përmirësime të vahsdueshme krahasuar me vitin 2010. Kapaciteti i transformatorëve për shkak të investimeve në rrjetin 400-220;400-110 kV nga 1500 MVA gjatë vitit 2010 është rritur në 1800 MVA në vitin 2011, që paraqet performancë të rritur për 20%, kurse kapaciteti i linjës 220-110kV nga 1050 MVA është rritur në 1350 MVA ose 28,57 %. Numri i ankesave për tension nga 8 në vitin 2010 ka ra në 2 gjatë vitit 2011. Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë më të vogla në periudhën 2011 se sa në vitin 2010. Detajet e performancës operative janë dhënë në pjesën 3.3. të këtij Raporti.

Bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues të KOSTT tregon se mbi 26.16% të rrjedhave fizike të energjisë nëpër rrjetin transmetues janë tranzit i energjisë për nevoja regjionale, dhe për këtë shërbim, KOSTT edhe më tutje nga mekanizmi i ITC-së nuk është duke u kompensuar por kompensohet EMS (TSO e Serbisë).


Performanca financiare e KOSTT-it gjatë vitit 2011 do të ishte më e lartë, sikur KEK të paguante faturat për shërbimet e transmisionit. për muajt Nëntor dhe Dhjetor 2010 gjë që ka vazhduar edhe në vitin 2011 (tetor, nëntor dhe dhjetor).

Sa i përket planit të vitit 2011, KOSTT ka arritur caqet objektive të Planit të Biznesit dhe IKP-të e performancës operative dhe financiare janë pozitiv. Bordi në mënyrë të rregulltë ka vlersuar parametrat e performancës së KOSTT-it.

1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it

Ngjarjet të cilat kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it paraqesin njëkohësisht edhe risqet me të cilat KOSTT-i ballafaqohet dhe që në mënyrë direkte afektojnë funksionimin e KOSTT-it.

a) Çështja e pazgjidhur e alokimit të kapaciteteve interkonektive me vendet fqinje si pasojë e marrëdhënieve të pazgjidhura me Serbinë.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

b) Refuzimi i KEK-ut për pranimin e faturave për muajt Nëntor dhe Dhjetor 2010 gjë që ka vazhduar në vitin 2011 dhe kontesti i iniciuar tek ZRRë në lidhje me refuzimin e KEK-ut që të paguaj faturat e KOSTT-it për muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2011.

c) KOSTT nuk është duke e kontrolluar plotësisht operimin e transmisionit në pjesën veriore të Mitrovicës si pasojë e mosdëgjueshmërisë së operatorëve në nënstacionin Vallaq dhe involvimit jolegal të operatorit të sistemit EMS nga Serbia.

d) KOSTT është duke aplikuar në Asociacionet ndërkombëtare të Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit (ENTSO-E), me të cilët operojmë në mënyrë sinkrone, gjë e cila na mundëson ndër të tjera edhe pjesëmarrjen në mekanizmat e përbashkëta që valorizojnë çdo transaksion ndërkufitar. Valorizimi i aranzhmaneve ndërkufitare mund ti sjellë të hyra në dobi të KOSTT-it dhe konsumatorëve të Kosovës. Mospranimi i mundshëm i KOSTT në ENTSO-E është një rrezik i mundshëm.


e) Vendimi i ZRRë që pranon të drejtën që KEK-u është obligues për pagesën e faturave të vitit 2010 në lartësinë prej 3.880.812,00€ por çuditërisht, nuk kërkon që kjo pagesë të ekzekutohet por në procesin tarifor 2011 të i zbritet KEK-ut, sepse në mënyrë tërthore, tërësisht jashtë rregullave, merr vendim që këtë shumë ta zbres nga të hyrat e KOSTT-it.

1.6. Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm

KOSTT është punëdhënës atraktiv i i cili edhe në vitet e ardhshme do të krijojë një ambient për investimin në zhvillimin profesional të punëtorëve dhe t'i motivojë në arritjen e performancës së standardeve më të larta. KOSTT-i do të vazhdojë punën e suksesshme edhe vitin e ardhshëm sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit. Kjo ndërlidhet edhe me mirëmbajtjen dhe aktivitetin e avancimit të funksioneve të operimit të sistemit elektrik të transmisionit e që rezulton në ngritjen e performancës së sistemit të transmisionit. Në të njëjtën kohë, KOSTT do të vazhdojë të krijojë kushtet për operimin e tregut në pajtim me zhvillimet e pritura të tregut.

Gjatë viteve në vijim presim që KOSTT edhe më tutje të sigurojë qëndrueshmërinë financiare dhe të vazhdojë të funksionojë si një organizatë efektive dhe efikase e cila gjithnjë punon në përmirësimin e performancës së punës.

Nga KOSTT-i, bazuar në Planin e Biznesit, pritet të merr pjesë aktive në operimin dhe zhvillimin e tregut rajonal dhe në këtë mënyrë të përfitojë dhe të kontribuojë nga zhvillimi rajonal dhe në mekanizmat ndërkombëtare. Në këtë aspekt vlen të ceket edhe synimi i KOSTT-it që të antarësohet në ENTSO-E dhe të bëhet pjesëmarrës në të gjitha mekanizmat rajonale dhe evropiane.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Detyrë e vazhdueshme e KOSTT-it është që të krijojë një ambient të sigurt pune, zhvillojë marrëdhënie efektive me palët e interesit dhe të sigurojë se KOSTT është dhe do të mbetet një organizatë e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor.

1.7. Infomacione lidhur me kapitalin dhe dividendën

Kapitali themeltar i KOSTT-it në momentin e regjistrimit ka qenë 25.000 (njëzetepesëmijë) Euro dhe është i ndarë në 2.500 (dymijepesëqind) aksione me vlerë nominale 1 (një) Euro secili. Kapitali i Shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar tërësisht në momentin e themelimit të KOSTT-it .

Aksionari i vetëm i KOSTT-it është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Të gjitha ndryshimet e kapitalit themeltar, bëhen sipas përcaktimit në Ligjin Nr. 02/L-123, "Për Shoqëritë Tregtare", ku përfshihet, shuma, parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themeltar, zvogëlimi i kapitalit themeltar, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksioneve, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themeltar, riblerja ose revokimi i aksioneve, etj.

Struktura e kapitalit është paraqitur në tabelën vijuese:


	Kapitali aksionar	Kapitali i trashëguar	Fitimi i mbajtur EUR	Total
Kapitali aksionar në para	25,000			25,000
Kontributet tjera jo para		28,346,963		28,346,963
Fitimi për periudhën e mëhershme				14,084,667
Fitimi i muajve të mëhershëm				-
Shtesat e share premium		15,040		
Fitimi për periudhë			88,716	88,716
Bilanci me 31.12.2011	25,000	28,362,003	88,716	42,545,346

Gjatë vitit 2011 nga KOSTT-i nuk është kërkuar të paguaj dividendë .

Gjatë vitit 2011 nuk kemi hyrë në marrëdhënie të reja kreditore. Nga Marrëveshja për financimin e Linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri, gjatë vitit 2011 është paguar vetem pjesa për provizionin e zotimit në vlerë prej 42,500 euro.

1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit


KOSTT gjatë vitit 2011 ka bërë investime të shumta bazuar në Planin e tij zhvillimor. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2011 janë realizuar me rregull

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 15 nga 96</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

dhe sipas afateve siç janë përcaktuar në planin e Biznesit dhe në planin individual të Departamentit për Zhvillim dhe Projekte të KOSTT-it. Më poshtë janë përmendur projektet investive dhe burimet e financimit të projekteve në mënyrë të përgjithësuar, ndërsa statusi i tyre dhe detajet janë pjesë e këtij Raporti .

Gjatë vitit 2011 KOSTT ka investuar në projektet e paraqitura në vijim:


- a) Projekti i Rehabilitimit të NS 220/110 kV – Kosova A i cili ka qenë i financuar nga Buxheti i Kosovës
- b) Paket Projekti i NS 400/110 kV – Peja 3 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 dhe 110 kV, i financuar nga Buxheti i Kosovës dhe KfW
- c) Shërbime Konsulentësh për Paket Projektin NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 dhe 110 kV, I financuar nga ECLO
- d) Paket Projekti Ferizaj-2, LOT-1: NS 400/110 kV Ferizaj 2, i financuar nga Buxheti i Kosovës
- e) Paket Projekti Ferizaj-2 LOT-2: LP ndërlidhëse 400 dhe 110 kV, i financuar nga ECLO,
- f) Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërtimit të LP 400kV, Kosovë – Shqipëri, i financuar nga KfW
- g) Shërbime Konsulentësh për Projektin SCADA/EMS dhe Telekom, i financuar nga Buxheti i Kosovës;
- h) Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekom LOT-1: SCADA/EMS, i financuar nga Buxheti i Kosovës
- i) LOT 1 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i ATR3 150 MVA në NS Prishtina 4 i financuar nga KOSTT-i
- j) LOT 2 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i Pajisjeve të TL në NS Prishtina 4 i financuar nga KOSTT-i
- k) Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 dhe Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) dhe TI për Operatorin e Tregut (LOT2) i financuar nga ECLO
- l) Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 dhe Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) i financuar nga ECLO
- m) TI për Operimin e Tregut (LOT2) i financuar nga ECLO në vlerë prej 834,287.00 €
- n) Ndërrimi i pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Kosova B ana 400 kV I financuar nga KOSTT-i
- o) Ndërrimi i përcuesit, izolatorëve dhe paisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3 I financuar nga KOSTT
- p) Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2) i financuar nga KOSTT
- q) Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3 i financuar nga KOSTT

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 16 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

- r) Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese) i financuar nga KOSTT-i
- s) Ndarja e zbarrave në dy seksione, i financuar nga KOSTT-i
- t) Rialokimi I linjës 110kV , nr.1806 NS Gjakov 1-Gjakova 2 dhe rehabilitimi I pajisjeve të TL në NS Gjakova 1 i financuar nga KOSTT-i
- u) Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetjake në NS 400/220kV, Kosova B i financuar nga KOSTT-i

Të gjitha projektet janë kryer brenda afatit optimal dhe pa probleme të dukshme kurse Komisioni i Bordit për Projekte Kapitale e ka përcjellur statusin e projekteve gjatë mbledhjeve që janë mbajtur gjatë vitit 2011

Në listën e mësipërme paraqiten investimet që kanë përfunduar para vitit 2011, por me pagesa të prapambetura, investimet e filluara para 2011 por të përfunduara në vitin 2011, si dhe investimet e nisura gjatë vitit 2011, implementimi i të cilave vazhdon në vitet vijuese.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv

2.1. Arritjet kryesore

Një ndër detyrat kryesore të KOSTT është ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit. Në këtë drejtim, performanca e operimit të sistemit të transmisionit në vitin 2011 ka pasur ngritje të theksuar. Linjat dhe nënstacionet janë mirëmbajtur sipas planit të paraparë, janë realizuar kontrollimet/inspektimet e nënstacioneve dhe linjave, janë realizuar remontet e rregullta vjetore të fushave nëpër NS dhe janë bërë energjizimet e NS-ve, duke përfshirë komisionimin dhe testimin e mbrojtjeve rele, si dhe implementimin e projekteve të rëndësishme¹.

Implementimi i suksesshëm i projekteve do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të KOSTT. Në kuadër të kësaj, vlen të përmendet lëshimi në operim i NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat ndërlidhëse 400 dhe 110 kV, që lidhin këtë nënstacion me NS Kosova A, NS Ferizaj 1, NS Sharri, NS Gjilani 5; lëshimi në operim i NS 110/10 (20) kV Skenderaj bashkë me Linjat ndërlidhëse 110 kV, që lidhin këtë nënstacion me NS Peja 3 dhe NS Vallaq, etj.

Këto dhe shumë aktivitete tjera kanë ndikuar në ngritjen e performancës së sistemit të transmisionit dhe në vitin 2011 ka pasur ngritje të theksuar.

Të arriturat e KOSTT, respektivisht, progresi që KOSTT ka bërë gjatë vitit 2011, janë paraqitur më detalisht në pikën 3.4 të këtij Raporti, i cili shqyrton implementimin e Planit të Biznesit për vitin 2011.


Megjithatë, vlen për t'u përmendur disa nga indikatorët themelor të performancës së sistemit të transmisionit:

- Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmisionit rregullisht kanë qenë më të vogla se ato të planifikuara dhe në krahasim me vitin paraprak. Gjatë vitit 2011, janë realizuar 66.93% të humbjeve të parapara në rrjetin e transmisionit dhe 88.01% të humbjeve të realizuara në vitin paraprak (2010). Kjo, padyshim, paraqet një ndër performancat më të rëndësishme të sistemi.

- Numri i ankesave për kualitet të tensionit dhe energjia e pafurnizuar në krahasim me vitin paraprak, janë zvogëluar dukshëm. Kjo tregon se investimet në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimi i sistemit dhe mirëmbajtja preventive, kanë ndikuar në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit gjë që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

Zhvillimi i infrastrukturës fizike është përcjellë edhe me zhvillimin e infrastrukturës ligjore dhe rregullative. Janë shpallur edhe ligjet e reja për sektorin e energjisë, dhe

¹ Projektet konkrete, energjizimi i të cilave është bërë, si dhe projektet e implementuara, janë dhënë në pikën 2.4. të këtij Raporti, në kuadër të progresit me Planin e Biznesit.


	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 18 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

për këtë qëllim, KOSTT ka dhënë kontributin e vet me komentimin e draft dokumenteve të lëshuara për konsultim nga Zyra e Rregullatorit për Energji , si pjesë e procesit të harmonizimit të legjislacionit sekondar në përputhje me Ligjet e Reja të Energjisë. Në bazë të kësaj, KOSTT ka filluar hartimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike dhe dokumenteve tjera teknike të cilat qeverisin operimin e sistemit të tregut. Kjo nënkupton kalimin nga faza ekzistuese e Modelit të Tregut në një fazë më të avancuar që implikon dizajnimin e një tregu të energjisë elektrike të përshtatshëm për investimet në sektorin e energjisë elektrike dhe në harmoni me kërkesat që dalin nga TKE. Në gusht të këtij viti, këto përpjekje kanë rezultuar me dorëzimin në ZRRë për miratim të Draftit final të Dizajnit të Tregut.

Punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimi të të gjitha resurseve të KOSTT, më së miri e dëshmon opinionin e auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2010, i cili për të pestën herë rradhazi, është pa asnjë kualifikim. Poashtu, KOSTT ka kryer me kohë obligimet ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës.

Janë aprovuar shumë dokumente të rëndësishme, politika dhe procedura në harmoni me dispozitat e Ligjit të Punës.

Në harmoni me objektivën e saj strategjike që të jetë një punëdhënëse atraktive, KOSTT ka bërë implementimin e sigurimit shëndetësor edhe për 1 vit për të gjithë punëtorët e saj. Me këtë është dëshmuar edhe një herë se burimet njerëzore janë aseti më i rëndësishëm i KOSTT.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.2. Ngjarjet kryesore të vitit

1) Projekti i linjës 400kV Kosovë – Shqipëri

Gjatë tremujorit të parë 2011, KfW ka pranuar ofertat për implementimin e projektit të linjës 400kV Kosovë – Shqipëri, dhe është punuar vlerësimi preliminar i përgjegjshmërisë së tyre.

2) Shqyrtimi i Pestë i Tarifave të Energjisë Elektrike

Në bazë të parimeve dhe orarit për shqyrtimin tarifor të përcaktuar nga ZRrE, me datë 28 janar KOSTT ka dërguar në ZRrE aplikacionin e përgatitur me të gjitha të dhënat dhe arsyeshmërinë për të hyrat e lejuara për periudhën e shqyrtimit të pestë tarifor në Modelin Tarifor, përgatitja e arsyeshmërisë etj.

Më 22 shkurt KOSTT ka pranuar nga ZRrE dokumentin “Raporti Konsultativ për KOSTT sh.a dhe për KEK sh.a. lidhur me Shqyrtimin e Pestë të Tarifave të Energjisë Elektrike” dhe sipas orarit të caktuar nga ZRrE, me datën 04 mars ka dërguar në ZRrE komentet ndaj Raportit Konsultativ.

3) Inicimi i Kontestit ndaj KEK sh.a.


Më 09 shkurt 2011 KOSTT ka iniciuar kontestin ndaj KEK sh.a. për shkak të refuzimit të pagesës për shërbimet e transmisionit dhe kthimit të faturave për muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2010 nga ana e KEK-ut; mosnënshkrimi i KEK-ut i Marrëveshjes për Kyçe me KOSTT-in si dhe mospagesa e faturave të rekonciliimit për vitin 2008 dhe 2009 të dërguar nga KOSTT-i.

4) Vizita e Ministrit për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të RF të Gjermanisë

Në kuadër të bashkëpunimit të KOSTT me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Qeverinë e RF të Gjermanisë, gjatë muajit Maj, në kuadër të një vizite shtetërore në Kosovë, Ministri për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim i Republikës Federale të Gjermanisë, z.Dirk Niebel ka vizituar Nënstacionin 400/220 kV Kosova B me ç’rast edhe u vu gurthemeli në pikënisjen e linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri.

5) Pjesëmarrja në takimit të Grupit Rajonal për Planifikim

KOSTT ka marrë pjesë në takimin e Grupit Rajonal për planifikimin e zhvillimit të rrjetit të transmisionit (SECI) të mbajtur në Stamboll në tremujorin e parë. Ky takim është shfrytëzuar për lobim për anëtarësimin e KOSTT në ENTSO-E, dhe mekanizmat rajonal. Gjithashtu janë mbajtur takime edhe në Gjermani dhe Bruksel për të njëjtat tema.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 20 nga 96</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

6) Mirënjohje për kontributin e KOSTT në kuadër të Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave (CSR)

Në kuadër të konkursit për Biznesin më të Mirë të vitit organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), gjatë tremujorit të parë, në mesin e tetë bizneseve të shquara në vend, KOSTT-it iu nda mirënjohje për CSR, përkatësisht për përpjekjet e vazhdueshme në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe përkrahjen e artistëve të Kosovës.

7) Ankesa kundër Serbisë – Komentet në përgjegjet e Serbisë

Lidhur me kontestin/ ankesën kundër Serbisë, dhe në përgjegje të Hapjes së Kontestit, Serbia ka dorëzuar përgjegjen në Ankesë të Sekretariatit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE). KOSTT lidhur me këtë ka paraqitur komentet në përgjegjet, përkatësisht pretendimet e Serbisë, dhe ato i ka dorëzuar në Sekretariat dhe ZRRë.

8) Pjesëmarrja në Samitin e Biznesit SHBA – Ballkan

KOSTT ka marrë pjesë në kuadër të delegacionit shtetëror të Kosovës, dhe është përfaqësuar me një prezantim në Samitin e Biznesit SHBA – Ballkan, të mbajtur me 23-24 mars 2011, me ç'rast Kryshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli ishte pjesë e Panelit për Energji dhe njëkohësisht ka mbajtur një prezentim.

9) Bisedimet teknike me Serbinë

Me kërkesë të Zëvendës Kryeministres Edita Tahiri, në tremujorin e parë, KOSTT ka marrë pjesë në bisedimet teknike ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, të cilat janë ndërmjetësuar nga BE dhe mbështetur nga SHBA. KOSTT lidhur me këto ka ofruar dokumentacionin relevant dhe ekspertizën lidhur me çështjet e diskutuara.

10) Aprovimi i tarifave të transmisionit


Më 04 maj 2011 KOSTT ka pranuar njoftimin nga ZRRë lidhur me aprovimin e tarifave të transmisionit. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në mbledhjen e mbajtur me datë 14 prill 2011 ka nxjerrë vendim për aprovimin e tarifave dhe ngarkesave të transmisionit, që janë zbatuar nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) SH.A. nga data 1 prill 2011.

11) Ditët e Kosovës në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë

Me 30 qershor 2011 në Vjenë është mbajtur takimi për ditët e Kosovës në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, ku janë prezantuar arritjet e Kosovës karshi obligimeve që dalin nga Traktati. Me kërkesë të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik në takim ka marrë pjesë edhe KOSTT, ku është prezantuar puna lidhur me hartimin e modelit të tregut dhe sigurisë së furnizimit.

12) Shënohet 5 vjetori i themelimit të KOSTT

Me 4 korrik 2011, në një ceremoni solemne zyrtare, KOSTT ka shënuar 5 vjetorin e themelimit me ç'rast u shpalosën sukseset e kompanisë gjatë këtyre viteve të operimit.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Në ceremoni ishin të pranishëm rreth 300 përfaqësues të institucioneve vendore dhe të atyre jashtë vendit.

13) Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP)

Pas pranimit të raportit nga ZAP KOSTT ka hartuar planin për implementimin e rekomandimeve të nxjerra nga ZAP, të cilat janë paraqitur si pikë e veçantë e rendit të ditës.

14) Raporti i Auditorit të Jashtëm

Auditori i Jashtëm ka dorëzuar raportin final për auditimin e vitit fiskal të përfunduar me 31 dhjetor 2010, dhe sikurse edhe vitet paraprake, ky raport nuk përmban asnjë kualifikim, e që dëshmon vazhdimësinë e praktikave të mira kontabël të kompanisë.

15) Progresi i projektit të linjës 400kV Kosovë – Shqipëri

Për Projektin për ndërtimin e linjës 400kV Kosovë-Shqipëri kanë vazhduar përgatitjet për shpronësimin e trasesë së linjës deri në kufirin me Shqipëri.

16) Bisedimet teknike me Serbinë

Në kuadër të bisedimeve teknike ndërshtetërore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, menaxhmenti i KOSTT ka ofruar mbështetje teknike lidhur me temat dhe çështjet që kanë të bëjnë me transmisionin e energjisë elektrike dhe mekanizmat tjerë në të cilët KOSTT ballafaqohet me probleme në raport me Serbinë.

17) Dizajni i Tregut


Pas përfundimit të procesit të diskutimit dhe hartimit të dizajnit të tregut në kuadër të Grupit Punues Teknik, KOSTT me 16 Gusht 2011 ka dorëzuar në ZRRë dizajnin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë, i cili pas procesit të diskutimit me palët e interesit dhe diskutimit publik pritet të miratohet nga ZRRë.

18) Dukuritë e vjedhjeve të kablllove

Kohëve të fundit janë shpeshuar dukuritë e vjedhjes së kablllove tokëzuese me fije optike (OPGW), siç ka qenë rasti i vjedhjes së kablllos në linjën NS Kosova A – NS Prishtina 4, si dhe rasti i vjedhjes në linjën komunikuese NS Kosova B – Qendra Dispeçerike Nacionale. Kjo dukuri paraqet rrezik për operimin e sigurtë dhe të besueshëm të sistemit elektroenergjetik si dhe dëme materiale të konsiderueshme. KOSTT për këto raste ka njoftuar organet e sigurisë.

19) Marrëveshja Gjyqësore - Padia kundër KOSTT për lëndimin e punëtorit

Pas padisë së punëtorit të KOSTT për kompensim dëmi të shkaktuar nga lëndimi në punë është arritur Pajtimi Gjyqësor ndërmjet punëtorit të lënduar dhe KOSTT që KOSTT të paguaj shumën prej 50.000 euro në emër të kompensimit të të gjitha formave të dëmeve, dhe më këtë është mbyllur rasti në fjalë.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

20) Pjesëmarrja në mbledhjen e Këshillit të Ministrave

Me datën 6 tetor 2011 në Kinishjev të Moldavisë është mbajtur takimi i Këshillit të Ministrave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Gjatë takimi janë diskutuar temat lidhur me ndikimin në shoqëri të liberalizimit të tregut të energjisë, trajtimin e varfërisë në raport me pagesën e energjisë elektrike, si dhe planet vepruese lidhur me dimensionin shoqëror të liberalizimit të tregut.

Ndërsa në kuadër të punimeve të Këshillit Ministror të TKE ndër temat kryesore është diskutuar për progresin në zbatimin e reformave nga Palët e Traktatit, si dhe zbatimi i pakos së tretë legjislativë të BE nga Palët nënshkruese.

Gjatë diskutimeve KOSTT ka pasur një qasje proaktive në hartimin e konkluzave nga takimi i Këshillit. Gjatë kësaj vizite gjithashtu janë mbajtur edhe takime njoftuese dhe lobuese për ankesën e KOSTT, si dhe për emërimin e përfaqësuesit të Kosovës në Komitetin Këshillues të Këshillit të Ministrave në kuadër të Traktatit.

21) KOSTT anëtarësohet në Rrjetin e Kosovës për Përgjegjësi Shoqërore të Korporatave (Kosovo CSR Network)

Në vitin 2011 KOSTT është anëtarësuar në Rrjetin e Kosovës për Përgjegjësi Shoqërore të Korporatave (Kosovo CSR Network) dhe njëherit përfaqësohet edhe në Bordin e Drejtorëve të Rrjetit. Qëllimi primar i CSR Network është zbatimi i praktikave të përgjegjshme dhe etike nga institucionet anëtare të saj, përmes Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave (PShK). Përmes zbatimit të PShK, bizneset përkushtohen për të vepruar në mënyrë etike dhe për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik duke punuar me të gjitha palët relevante të interesit për të përmirësuar jetën e tyre në mënyra që janë të mira për bizneset dhe për shoqërinë në përgjithësi.


22) KOSTT është ricertifikuar për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008, me çka ka dëshmuar përkushtimin e vazhdueshëm në zbatimin e standardeve më të larta organizative profesionale.

23) Ankesa kundër Serbisë – Mendimi i Bazuar

Pas një angazhimi të ngjeshur dhe të gjatë, që nga viti 2008, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë sipas Procedurës për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë, ka nxjerrë Mendimin e Bazuar në të cilin konkludon se Serbia ka shkelur dispozitat e Traktatit, përkatësisht Nenin 3 të Rregullores 1228/2003 të Komisionit Evropian, për moskompensim të transitit të energjisë nëpër sistemin e transmisionit të Kosovës, dhe Nenin 6 të Rregullores 1228/2003 të Komisionit Evropian, për mos kompensim ndaj KOSTT të të hyrave nga alokimi i kapaciteteve interkonektive të Kosovës.

24) Transferimi i aseteve 110kV

Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 10/29 e datës 3 Gusht 2011 ka vendosur që asetet 400/220/110 kV dhe transformatorët 220/35/10(20) dhe 110/xkV si dhe fushat përkatëse me ndërprerësit e transformatorëve 35 kV dhe 10(20) kV të

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

transferohen nga KEK sh.a në KOSTT sh.a. Lidhur me këtë, Ministri për Zhvillim Ekonomik ka vendosur që të zhvillohen të gjitha përgatitjet për transfer të aseteve nga KEK-u në KOSTT.

25) Marrëveshja e Bashkëpunimit KOSTT – MEPSO

Me 20 tetor 2011 KOSTT dhe MEPSO kanë nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi për bashkëpunimin e ndërsjellë, e cila ndër të tjera parasheh bashkëpunim në nivel operativ, si dhe bashkërendimin e aktiviteteve për ndërtimin e linjës së re interkonektive 400kV Kosovë – Maqedoni si inicimin e studimit të fizibilitetit dhe themelimin e grupeve punuese të cilat do të identifikojnë fushat përkatëse teknike të bashkëpunimit.


Me këtë Marrëveshje gjithashtu parashihet nënshkrimi i Marrëveshjes për Interkoneksion ndërmjet KOSTT dhe MEPSO, e cila shërben si bazë për operim të përbashkët të linjës ekzistuese dhe bashkëpunimit operativ.

26) Plani Zhvillimor i Transmisionit 2012-2021

Më 16 dhjetor është dërguar në ZRrE drafti final i dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2012 – 2021”, i cili është aprovuar nga ZRrE me datën 29 dhjetor.

27) Komisionimi i NS Ferizaj 2 400/110kV

Ka përfunduar Projekti për ndërtimin e nënstacionit Ferizaj 2 400/110kV i financuar nga Komisioni Evropian dhe Qeveria e Kosovës.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 24 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

2.3.1. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për Janar-Dhjetor 2011


	Muajt MWh	Janar-Dhjetor 2011		
		E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
1	TC Kosova A	1 384 830	2 014 450	145.47
2	TC Kosova B	3 382 884	3 220 180	95.19
3	HC Ujmani	82 000	74 387	90.72
4	HC Lumbardhi	25 951	22 304	85.95
5	(1+2+3) Prodhimi gjithsejt	4 849 714	5 309 017	109.47
6	Devijimi	0	27 287	
7	Eksporti	0	371 164	
8	Importi	893 167	816 199	91.38
9	(5-6-7+8) Energjia në disponim	5 742 881	5 726 765	99.72
10	Distribucioni	4 480 274	4 524 192	100.98
11	Ferronikeli	678 279	597 269	88.06
12	Trepça	25 500	23 101	90.59
13	Sharri	64 000	59 962	93.69
14	Mihjet, Kosova Thengjilli Shpenzimet e gjen. nga			
15	transm.(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45)	126 400	406 925	
16	(10+11+12+13+14+15) Kërkesa neto	5 374 453	5 611 449	104.41
17	Humbjet në transmission	172 286	115 316	66.93
18	(16+17) Kërkesa gjithsej	5 546 739	5 726 765	103.25


Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2011, ndërsa të dhënat e realizuara nga pikat matëse dhe të transferuara në kufi të Kosovës.

Të dhënat në tabelë janë ilustruar edhe në diagramin vijues:


	RAPORT VJETOR		DT-PB-004
	ver. 1.0		<i>faqe 25 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>			<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Balanca e planifikuar 2011



	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 26 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Diagrami i bilancit të realizuar elektroenergjetik Janar- Dhjetor 2011 (GWh)



 Departamenti Financiar	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	ver. 1.0	<i>faqe 27 nga 96</i>
<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>		

2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës – operimi i sistemit

Nr	Indikator	2010		2011/2010(%)		Caku	Komenti
T1	Energjia e transmetuar (GWh)	8707,43	8443,97	96,97		Nuk mund të vendoset sepse nuk mund të parashihet transiti, e me këtë as hyrjet totale në transmision.	Caku nuk vendoset për këtë IKP
T2	Piku koincident (MW)	1156	1150	99,48		Caku: 1100MW (Sipas: Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2011).	Caku nuk vendoset për këtë IKP
T3	Gjatësia totale e linjave (km)	400 kV	181,815	188,49	103,67	= > 1	Caku mund të vendoset për çdo vit me ndërtimin e linjave të reja ose riparimin/rindërtimin e linjave të cilat aktualisht nuk janë në operim. Ky cak bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit.
		220 kV	231,83	231,83	100,00		
		110 kV	672,1085	764,94	113,81		
T4	MVA-km	400 kV	239450	248249	103,67		Caku është si në T3
		220 kV	77506	77506	100,00	= > 1	
		110 kV	78279	83209	106,30		
T5	Kapaciteti i transformatorëve	400-220,400-110 kV	1500	1800	120,00		Ky cak mund të vendoset për çdo vit për instalimin e transformatorëve të ri.
		220-110 kV	1050	1350	128,57	= > 1	
T6	Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC)						I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTISO-E
T7	Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal, Imp/Eksport						I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTISO-E



RAPORT VJETOR

DT-PB-004


ver. 1.0

faqe 28 nga 96

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buzheta

T8	Pagesa për kongjestion								KOSTIT do të fillojë kur ATC do të alokohen nga OT/kontrollohet nga OS për TTC teknike.
T9	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/vit)	230,25	157,82	68,54					AIT (Koha mesatare e rënies) 230,25 2010, ndërsa 157,82 minuta për periudhën e njëjtë 2011
T10	Numri i ankesave për tension	8	2	25,00					Caku për ankesa për tension duhet të ndërlihet me numrin e ankesave në vitin (et) paraparak në periudhën e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtër.
T11	Ankesat e zgjidhura për tension	Më pak se një javë	8	2	25,00				Caku për zgjidhjen e ankesave për tension duhet të jetë sa më i shkurtër (< 1 javë). Kjo nënkupton që përqindja më e lartë në kategorinë e parë, është më mirë.
		Më pak se një muaj							
		Më shumë se një muaj							
T12	Numri i ankesave për matje	0,00	0						Caku për ankesa të matjeve duhet të ndërlihet me numrin e ankesave për vitin(et) paraparak(e).
T13	Ankesat e zgjidhura për matje	Më pak se një javë	0,00	0					Caku për zgjidhjen e ankesave për matje duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur (< 1 javë). Kjo nënkupton që përqindja më e lartë në kategorinë e parë, është më mirë.
		Më pak se një muaj							
		Më shumë se një muaj							

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	ver. 1.0	faqe 29 nga 96
<i>Departamenti Financiar</i>		
<i>Sektor: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>		


T14	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	Import		17,84	21,38	119,83	20MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar		Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla.
		Import	Ekспорт				20MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar	20MWh/h shyerje jashta programit të deklaruar	
T15	Humbjet në transmision (GWh)			15,53	21,89	141,01			Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë më të vogla në periudhën 2011 se sa në periudhën 2010
				131,03	115,31	88,01			

AIT = (8760*60*ENS)/TE

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënies


ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar

TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar


 Departamenti Financiar	RAPORT VJETOR ver. 1.0	DT-PB-004 faqe 30 nga 96
	Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	

2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit

T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.00	0.00	0	> 1	Performancë negative
		220	0.00	2.59	0		
		110	1.38	1.28	92.75362319		
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	0	0.00	0	> 1	Performancë negative
		220	0	6.86	0		
		110	5.34	15.00	280.8988764		
T3	Koha mesatare e shkyqjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	0		
		110	0.00	0.00	0		
T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(tijësi)	400/220(110)	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220/110	0.00	0.10	0		
		400/220(110)	0	0.00	0		
T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë)	220/110	0	3.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		400/220(110)	0.00	0.00	0		
		220/110	0.00	0.00	0		
T6	Koha mesatare e shkyqjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220/110	0.00	0.00	0		
		400	0.00	0.00	0		
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	0.00	0.00	0	> 1	Performancë


	RAPORTI VJETOR		DT-PB-004	
	ver. 1.0		faqe 31 nga 96	
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti		

		220	0.00	3.30	0	negative
		110	4.88	6.46	132.3770492	
		400	0	0.00	0	
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	220	0	1.00	0	Performancë negative
		110	3.71	8.65	233.1536388	> 1
		400	0.00	0.00	0	
T9	Koha mesatare e shkyqjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	220	0.00	0.00	0	Performancë pozitive
		110	3.59	0.00	0	< = 1
		400	0.00	0.00	0	
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	220	5.54	2.77	50	Performancë pozitive
		110	6.40	0.00	0	< = 1
		400	0	2.77	0	
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)	220	6.29	0.00	126.6666667	Performancë negative
		110	0.00	0.00	0	> 1
		400	0.00	0.00	0	
T12	Koha mesatare shkyqjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	220	0.00	0.00	0	Performancë pozitive
		110	0.00	0.00	0	< = 1

 Departamenti Financiar	RAPORT VJETOR ver. 1.0	DT-PB-004 faqe 32 nga 96
	Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	

Spjegim:

- Indikatorët T1, T2, T7 dhe T8 paraqesin performancë negative me që ka ardhur deri te rritja e rënieve të linjave si pasojë e çështjeve teknike si dhe dështimi i polit të ndërprerësit të fuqisë, në fushën e LP 445/2, si pasojë e defektit nga prodhuesi.
- Indikatorit T11 paraqet performancë negative për shkak të prishjes së mbrojtjes distante në LP 293/2 në NS Prizreni 2 si rezultat i defektit në modulën që detekton dhe shkyç prishjet dhe për shkak të problemeve me çarqet furnizuese të transformatorëve rrymorë dhe mbrojtjes në këtë fushë.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 33 nga 96</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti


2.3.4. Operimi i tregut


Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral ku pjesa më e madhe e tregut është e rregulluar dhe mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar.

Të drejtën e konsumatorit të kualifikuar e shfrytëzon Feronikeli por, meqenëse nuk ka furnizues tjerë të licencuar, Feronikeli është furnizuar nga furnizuesi publik me kontratë me çmim të rregulluar. Për shkak të mungesës së konkurrencës dhe furnizuesve të tjerë dhe sipas ligjeve të reja, lejohet që konsumatori i kualifikuar të furnizohet nga Furnizuesi Publik me çmim të rregulluar i cili ndryshon nga niveli i tensionit ku ata janë të kyçur. Është arritë marrëveshja midis KEK, Feronikelit dhe ZRrE, që Feronikeli të furnizohet nga KEK me çmim të rregulluar në nivelin 220kV. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të rregulluar në nivelin 220kV do të paraqitet në këtë tremujor si raport i energjisë së konsumuar nga konsumatorët e privilegjuar (kualifikuar) në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë. Kjo përfshinë energjinë e përgjithshme që ka dalë nga transmissioni dhe energjinë që ka hyrë në distribucion nga Lumbardhi, e cila gjithashtu është pjesë e konsumit. Konsumi tarifor (pa Feronikelin) në nivel me pakicë në Janar-Dhjetor'11 ishte mesatarisht rreth 82.18% të konsumit të përgjithshëm bruto (duke mos përfshirë humbjet në transmision).

Në figurën në vijim paraqitur figurativisht madhësia e tregut të rregulluar (tarifor) në raport me tregun e parregulluar. Konsumi i KEK nga rrjeti i transmissioni për nevoja vetjake, i cili është i veçantë nga tregu tarifor dhe ai jo-tarifor, është i paraqitur gjithashtu në figurë

Tregu tarifor dhe jo tarifor në raport me konsumin





	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 34 nga 96</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Në vijim, është paraqitur bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues të KOSTT. Siç shihet, mbi 26.16% të rrjedhave fizike të energjisë nëpër rrjetin transmetues janë tranzit i energjisë për nevoja regjionale, dhe për këtë shërbim KOSTT edhe më tutje nga mekanizmi i ITC nuk është duke u kompensuar por kompensohet EMS (TSO e Serbisë).

Bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues për Janar-Dhjetor 2011


Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues *Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues dhe humbjet në transmision*



Në tabelë janë dhënë çmimet e rregulluara dhe të pa rregulluara të energjisë elektrike nëpër muaj. Duhet pas parasysh se viti kalendarik dhe viti tarifor ndryshojnë, prandaj edhe çmimet e rregulluara nuk janë të njëjta për të gjithë muajt e vitit. Çmimet e energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë janë marrë nga modelet tarifore 2009, 2010, 2011.


Në çmimin mesatar të sistemit ndikon dukshëm sasia e importit dhe çmimi i tij. Si shihet nga tabela, çmimi i importit të energjisë elektrike ka pasur rënie dhe si pasojë edhe çmimi i ponderuar i energjisë elektrike ka pasur rënie nga viti 2009 deri në vitin 2010, ndërsa në vitin 2011 kemi ngritje të çmimit mesatar të sistemit ku një nga arsyt është edhe ngritja e çmimit të importit për këtë tremujor.

Janë dhënë edhe çmimet e rregulluara dhe të parregulluara në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 36 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Çmimet e rregulluara dhe të parregulluara energjisë elektrike

		2009 €/MWh	2010 €/MWh	2011 €/MWh
Çmimet e rregulluara	Kosova B	22.16	23.34	24.06
	Kosova A	22.31	23.35	24.14
	HC Ujmani	24	25.99	27.48
	HC Lumbardhi	40	40	40
Çmimet e parregulluara	Importi - çmimi mesatar	75.9	57,95	69.66
	Eksporti - çmimi mesatar	20.17	26,45	45.05
Çmimi mesatar i ponderuar i sistemit		28.37	27.59	29.32

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 37 nga 96</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet


Në vazhdim, janë paraqitur Draft Pasqyrat Financiare (të pa audituara)

Draft Bilanci i Gjendjes

01/01/2011-31/12/2011				
	Note	2010 EUR	2,011 EUR	%
PASURITE JO QARKULLUESE		88,827,517	95,557,266	107.58
Palujtshmerite, impiantet dhe pajimet	4	88,791,747	94,100,167	
Aktiva afatgjate jo materiale	5	35,770	1,457,099	
PASURITE QARKULLUESE		32,034,155	29,910,111	93.37
Stoqet, pjeset rezerve dhe veglat	6	906,771	1,654,247	
Arketueshmerite dhe kerkesat tjera	7	9,389,785	6,635,037	
Huate, avanset dhe depozitat	8	6,887,535	3,015,345	
Tatimi ne te hyra				
Paraja ne arke dhe bilanci bankar	9	14,850,064	18,605,482	
		120,861,672	125,467,377	103.81
KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT		42,456,386	42,545,346	100.21
Kapitali aksionar	10	25,000	25,000	
Kapitali i trasheguar	11	28,346,963	28,346,963	
Fitimi per periudhen e mehershr		10,616,616	14,084,667	
Fitimi i mbajtur/ Fitimi i mbajtur/Janar-DHjetor/2011		3,467,808	88,716	
DETYRIMET JO KURENTE		69,392,339	75,413,685	108.68
Te hyrat e shtyera	12	69,392,339	75,413,685	
DETYRIMET KURENTE		9,012,947	7,508,346	83.31
Pagueshmerite dhe obligimet tjera	13	8,671,592	7,445,503	
Detyrimi I tatimit te periudhes		156,691		
Detyrimi I tatimit te shtyer	14	184,664	62,843	
		120,861,672	125,467,377	103.81


Forma e notave ne anekse jane pjese integrale e ketyre pasqyrave financiare

Drejtori Financiar


	RAPORT VJETOR		DT-PB-004
	ver. 1.0		<i>faqe 38 nga 96</i>
-Departamenti Financiar-		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	

DRAFT PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBESJES

	Nota	Plani Janar-Dhjetor 2010	Realiz. Janar-Dhjetor 2010	% real/plani 2010	Plani Janar-Dhjetor 2011	Realiz. Janar-Dhjetor 2011	% real/plani 2011	% realiz 2011/2010
Të hyrat nga tarifa	15	18,309,867	20,075,727	110%	14,230,218	14,706,299	103%	73.25%
Të hyrat tjera	16	0	2,649,000		2,920,000	4,085,546	140%	154.21%
Të hyrat totale		18,309,867	22,724,727	124%	17,150,218	18,791,845	110%	82.69%
Shpenzimet e personelit	17	2,652,813	2,647,719	100%	2,670,681	2,817,473	105%	106.41%
Shpenzimet e materialit		52,000	36,946	71%	52,000	44,616	86%	120.76%
Kompenzimet - Bordi i Drejtorëve			75,033			88,642		118.14%
Rregullimi sekondar		1,623,900	1,600,000	99%	-	-		
Amortizimi	4	5,200,000	4,865,529	94%	5,200,000	6,349,626	122%	130.50%
Energjia, telefoni, uji		211,000	225,765	107%	229,000	244,776	107%	108.42%
Riparime dhe mirëmbajtje	18	921,243	752,366	82%	1,113,489	743,722	67%	98.85%
Derivate dhe lubrifikante		93,202	75,823	81%	93,202	88,150	95%	116.26%
Medicina, siguria dhe transporti	20	293,000	249,128	85%	312,000	194,139	62%	77.93%
Shpenzimet tjera operative	19	690,582	959,550	139%	1,200,018	784,310	65%	81.74%
Kompenzimet tjera.		98,000	12,644	13%	100,000	38,462	38%	304.19%
Humbjet në bartje	21	5,479,807	4,319,081	79%	4,019,475	3,578,893	89%	82.86%
Total shpenzimet para provizioneve		17,315,547			14,989,865	14,972,809	99.9%	


	RAPORTI VJETOR		DT-PB-004	
	<i>ver. 1.0</i>		<i>faqe 39 nga 96</i>	
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>		

Prov. i kërkesave kontestuese		2,764,339		3,345,610	
Shpenzimet totale	17,315,547	18,583,922	107%	14,989,865	122%
Fitimimi para Tatimit	994,320	4,140,805	416%	2,160,353	22%
Tatimi ne fitim	22	673,000		384,710	
Fitimimi për periudhë	994,320	3,467,805	349%	2,160,353	4%
				88,716	2.56%

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 40 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Draft Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

	2010	2011
	EUR	EUR
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE		
Fitimi gjatë vitit	3,467,808	88,716
Përshtratjet për:		
Të hyrat nga interesi	(300,893)	(543,127)
Shlyerja e mjeteve themelore.	8,011	4,569
Amortizimi i palujtshmërive, impianteve dhe pajisjeve	4,865,529	6,349,626
Të hyrat e shtyera	(1,826,808)	(3,108,086)
Rrjedha operative e parasë para lëvizjeve në kapitalin punues	6,213,647	2,791,698
Rritje e Stoqueve nga Grantet		661,450
Rritje-zvoglimi në stoqe,pjesë rezervë dhe vegla-inventari	108,666	(747,476)
Rritje-zvoglimi në Arkëtueshmëri dhe kërkesa tjera	812,095	2,754,749
Rritje -zvoglimi në parapagime dhe depozitës ndaj furnitorëve	1,614,325	3,872,188
Rritje-zvoglimi në pagueshmëri dhe obligime tjera	1,574,167	(1,567,200)
Detyrimi i tatimit të periudhës.	(324,955)	
Detyrimi për tatimin e shtyer.	16,400	
Gjenerimi i parasë nga aktivitetet operative	10,014,346	7,765,409
Pagesa e tatimit në të hyra		
Paraja neto nga aktivitetet operative	10,014,346	7,765,409
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTIVE		
Të hyrat nga BK-donacion kesh	14,019,000	7,384,513
Pagesa e donacioneve-Kthimi i Mieteve në Buxhetin e Kosovës.	(161,000)	
Intersi i pranuar	300,893	543,127
Blerja e aseteve të reja	(18,459,678)	(11,937,631)
Paraja neto nga aktivitetet investive	(4,300,785)	(11,394,504)
Rritja neto e parasë dhe ekuivalenteve të parasë	5,713,561	3,755,419
Paraja dhe ekuivalentet e parasë me 31.12.2010	9,136,503	14,850,064
Paraja dhe ekuivalentet e parasë me 31.12.2011	14,850,064	18,605,483

 Departamenti Financiar	RAPORT VJETOR ver. 1.0	DT-PB-004 faqe 41 nga 96
	Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	

Draft Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Perfundimisht JANAR-DHIJETOR/2011

	Kapitali aksionar	Kapitali i trashëguar	Fitimi i mbajtur	Total
	----- EUR -----			
Kapitali aksionar në para	25,000			25,000
Kontributet tjera jo para		28,346,963		28,346,963
Fitimi për periudhën e mëhershme			14,084,667	14,084,667
Fitimi i muajve të mëhershëm			-	-
Shtesat e share premium		15,040		15,040
Fitimi për periudhë			88,716	88,716
Bilanci me 31.12.2011	25,000	28,362,003	88,716	42,545,346

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 42 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Informacionet për vitin financiar 2011

Fitimi para tatimit për vitin 2011 është në vlerë 473,426 euro, si rezultat i ndikimit të provizionimit të kërkesave kontestuese në vlerë prej 3,345,610 euro.

Realizimi i shpenzimeve në vlerë prej 18,318,419 euro apo 22 % mbi vlerën e planifikuar është për shkak të provizionimit të kërkesave të pa paguara nga KEK sh.a në vlerë 3,345,610 euro. Realizimi i shpenzimeve operative para provizionimit të kërkesave është 99,9 % cka tregon se nuk kemi tejkalime të shpenzimeve krahasuar me planin.

Të hyrat gjatë vitit 2011 kanë qenë më të ulëta se në vitin paraprak për 17.3%, për shkak të zvoglimit të tarifave nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Te hyrat e realizuara nga tarifa në vlerë 14,706,299 janë më të ulëta se shpenzimet operative para provizionimit në vlerë 14,972,809 . Ky është një tregues mjaft shqetësues për arsye se të hyrat e realizuara pas ndryshimeve të bera në tarifa nuk i mbulojnë shpenzimet operative .

Me që kemi pasë një fitim të akumuluar nga vitet paraprake, ky zvoglim nuk ka ndikuar në ndryshimin e caceve të vendosura me Planin e Biznesit.


Asetet joqarkulluese janë në vlerën prej 95,577,266 euro, pasuritë qarkulluese 29,910,111 euro dhe gjithësejt pasuria e KOSTT sh.a. në vitin 2011 është në vlerën 125,467,377 euro. Gjatë vitit 2011, krahasuar me vitin paraprak, asetet joqarkulluese janë rritë për 7.6%, pasuritë qarkulluese (kapitali punues) janë zvogluar për 6.6%.

Në zvoglimin e pasurive qarkulluese ndikim kryesor ka pasë provizionimi i kërkesave kontestuese nga KEK sh.a në vlerë prej 3,880,906 euro

Pasuria e KOSTT sh.a. në vitin 2011 është rritë për 3.8%

Kapitali akcionar dhe rezervat janë në vlerën 42,545,346 euro, detyrimet afatgjata (të hyrat e shtyera) 75,413,685 euro dhe detyrimet afatshkurtëra 7,508,346 euro.


Struktura e kapitalit nuk ka ndryshuar dhe është e rritur vetëm për vlerën e fitimeve të mbajtura.

 Departamenti Financiar	RAPORT VJETOR ver. 1.0	DT-PB-004 faqe 43 nga 96
	Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	


2.3-6. Analiza e IKP-ve financiare

Në vazhdim, janë dhënë IKP-të që paraqesin performancën financiare të KOSTT-it gjatë vitit 2011.

T1. Fitim i operativ marginal = Fitimi neto / gjithësejt të hyrat	0.18	0.03	Qëllimi është që të jetë mbi zero. Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese. Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj. Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë.
T2. Treguesi i qarkullimit = asetet qarkulluese/detyrimet qarkulluese	3.55	4.08	Tregon aftësinë e kompanisë për t'i përmbushur obligimet e saj afatshkurtera, me mjetet (asetet) e saj afatshkurtera. Optimalja e këtij treguesi është 1.5.
T3. Mbulimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes: të hyrat e rregull./shp. e mirëmbajtjes	29.82	19.80	Në rastin kur do të realizohej e tërë mirëmbajtja e planifikuar, ky tregues do të kishte vlerën 12.8 (14,230,218/1,113,489), që do të ishte rasti ideal.
T5. Mbulimi i të hyrave = gjithë të hyrat/ shpenzimet e lejuara	1.29	1.25	Treguesi duhet të jetë më i madh se 1 ose = 1


	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	ver. 1.0	<i>faqe 44 nga 96</i>
<i>Sëktori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>		
<i>Departamenti Financiar</i>		

T6. Mbulimi i shpenz. të lejuara = shpenzimet e lejuara/ gjithësejt të hyrat	0.77	0.80	Treguesi duhet të jetë më i vogël se 1 ose = 1
T7. Gjith. të hyrat ndaj të hyr. të lej = gjith. të hyrat e rregulluara/ të hyrat e lejuara	1.22	1.10	Këtu vihen në raport vetëm të hyrat e rregulluara të realizuara dhe të hyrat e lejuara. Treguesi duhet të jetë = 1. Për shkak të rrjedhave më të mëdha të energjisë, treguesi është më i madh se 1.
T8. Qarkullimi i arkëtueshmërisë = gjithësejt të hyrat/ mesatarja e llog. të arkët.	2.99	3.35	Duhet të jetë 4.1 në mënyrë që të realizohet objektivi (i paraqitur në treguesin më poshtë), që periudha mesatare e arkëtimit të jetë 90 ditë. (365 ditë/4.1)
T9. Periudha mesatare e arkëtimit = 365 ditë/ qarkullimi i arkëtueshmërisë	122 ditë	108 ditë	90 ditë
T10. Shpenzimet e lejuara për km. të rrjetit	14.60 €/km	12.64 €/km	Kosto e shpenz. të lejuara për km të rrjetit është më e ulët krahasuar me vitin paraprak.
T12. Shpenzimet e lejuara për GWh e transmetuara	1.99	1.78	Ky indikator ndërlidhet me metodologjinë e tarifave të ZrrE-së, e cila për periudhën raportuese ka lejuar shpenzimet totale për njësi 1.78 m €/GWh. Ky tregues tutje analizohet duke iu referuar treguesit T14, që paraqet shpenzimet totale (të realizuara) për njësi, ku shihet se KOSTT ka transmetuar energji me shpenzimet reale 2.17 m €/GWh. Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike.
T13. Të hyrat e lejuara për GWh e transmetuara	2.10	2.03	Paraqet të hyrat për njësi. Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike
T14. Shpenzimet totale për njësi = shpenzimet totale/GWh e transmetuara	2.13	2.17	Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike.

	RAPORTI VJETOR	DT-PB-004
	ver. 1.0	faqe 45 nga 96
Departamenti Financiar		
Sëktori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti		

T15. Detyrimet ndaj aseteve = (dety. afatshk + det.afatgjat)/ gjith.sasetet	0.07	0.06	Qëllimi është që të jetë më i vogël se 1.
T16. Kthimi në asete neto (RONA) = fitimi neto/asete neto	0.04	0.004	Objektivi: të jetë më i madh se mesatarja e industrisë
T17. Treguesi i ekuilitetit = gjith.s.të hyrat/ kapitali	0.20	0.16	Objektivi: më i madh se 0
T18. Asetet neto = gjith.s.asetet-detyrimet	111,849	118,405	Objektivi: Asetet > Detyrimet
T19. CAPEX-i ndaj km. të rrjetit	15.56	11.03	Objektivi: të jetë sa më i madh
T20. Huatë afatgjata ndaj aseteve = hua afatgjate/ gjith.s.asetet			Treguesi nuk është llogaritur pasi, gjatë vitit 2010 është paguar vetëm proviziononi për kredinë e kfw.

Vërejtje: Indikatorët T5 dhe T14, kanë të bëjnë me të hyrat dhe shpenzimet e lejuara bazuar në metodologjinë e tarifave. Për t'u caktuar caku real, duhet të mbliidhen të dhënat mbi kostot historike.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 46 nga 96</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

2.4. Progresi me Planin e Biznesit


Roli i KOSTT-it është që të operojë sistemin e transmisionit dhe tregut të energjisë elektrike në Kosovë, me një mision të qartë që të sigurojë shërbime kualitative duke implementuar të arriturat teknike-teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit, transparencë dhe jo-diskriminim në tregun konkurrues të energjisë elektrike dhe avansim të pozitës në nivelin rajonal dhe evropian, përkrahur nga ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve njerëzore.

Në përputhje të plotë me vizionin e vet, KOSTT synon që “Të jetë kompani financiarisht e qëndrueshme, për transmetimin me besueshmëri dhe siguri të lartë të energjisë elektrike, e përgjegjshme ndaj shoqërisë dhe mjedisit, ofruar i shërbimeve sipas kërkesave të klientëve në tregun aktual dhe në tregun e lirë të energjisë dhe e integruar në mekanizmat evropianë”.

Duke u nisur nga misioni i KOSTT në një rën anë, dhe për të realizuar synimet e pëcaktuara, janë vendosur edhe objektivat, pjesa dërmuese e të cilave janë objektiva strategjike dhe të cilat do të hasen edhe në planet e biznesit edhe për disa vite me radhë.

Objektivat e vendosura të KOSTT për vitin 2011 janë:

- sigurimi i zhvillimit dhe ndërtimit efektiv të rrjetit të transmisionit
- mirëmbajtja dhe përmirësimi i funksioneve të nevojshme për operimin e sistemit
- krijimi i kushteve për operimin e tregut në pajtim me zhvillimet e pritura të tregut
- ngritja e performancës së sistemit të transmisionit
- avancimi i planifikimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të sistemit
- sigurimi i qëndrueshmërisë financiare
- funksionimi edhe më tutje si një organizatë efektive dhe efikase dhe arrijtja e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së punës
- pjesëmarrja aktive në operimin dhe zhvillimin e tregut rajonal përfitimi /kontribuimi nga zhvillimi rajonal) si dhe në mekanizmat ndërkombëtare
- anëtarësimi në ENTSO-E që do të sigurojë KOSTT pjesëmarrjen në të gjithë mekanizmat rajonal dhe evropianë
- vendosja e marrëdhënie efektive me palët e interesit
- të sigurojë se KOSTT është punëdhënës atraktiv, të krijojë një ambient për investimin në zhvillimin profesional të punëtorëve dhe t'i motivojë në arritjen e performancës së standardeve më të larta
- të sigurojë se KOSTT është një organizatë e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor
- krijimi i një ambienti të sigurtë pune

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 47 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Të arriturat e KOSTT gjatë vitit 2011, do të analizohen duke pasë si pikënisje objektivat e lartcekura nga Plani i Biznesit 2011, respektivisht, implementimi këtij Plani.

Performanca e operimit të sistemit të transmisionit në vitin 2011 ka pasur ngritje të theksuar. Numri i prishjeve të transformatorëve, të linjave dhe të mbrojtjeve rele është zvogëluar. Poashtu, është shkurtuar koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit (fushës) dhe mbrojtjes rele².

Bazuar në planin e mirëmbajtjes për vitin 2011 KOSTT ka arritë të realizojë 98 % të planit fizik. Aktivitetet kryesore të cilat janë përfshi në planin e mirëmbajtjes janë: kontrollimi me termovision i elementeve lidhëse dhe stabilimenteve elektroenergjetike, analiza e shpërndarjes së gazrave në autotransformatorët elektroenergjetikë, kontrollimi nga toka i linjave, kontrollimi i përgjithshëm i nënstacioneve, remonti i linjave, remonti i nënstacioneve, testimi dhe shqyrtimi i stabilimenteve etj.

Janë bërë avansime në ngritjen e funksioneve operative të planifikimit dhe veçmas në operimin e sistemit në kohën reale. Që nga viti 2011 për herë të parë është mundësuar monitorimi dhe kontrolli në kohën reale i çdo pjese të rrjetit transmetues të Kosovës, përveç pjesës veriore ku për shkaqe të njohura nuk është mundësuar ende përfshirja e NS Vallaq dhe HC Ujmani.


Poashtu janë krijuar rrethanat e plota për simulimin e të gjitha situatave dhe bërja e analizave para dhe pas operative.

Këto mundësi për avansimin e operimit të sistemit, veçënisht i ka mundësuar projekti i përmbyllur gjatë vitit 2011 i SCADA\EMS dhe Telekomit, në kuadër të të cilit është ngritur infrastruktura moderne me veçoritë e lartëpërmendura. Poashtu, përparimet në operimin e sistemit nga aspekti i matjeve komerciale janë përmirësuar me mundësimin e leximit të të dhënave kumulative të energjisë elektrike në të gjitha pikat kufitare të rrjetit transmetues përmes lidhejeve optike, në pronësi të KOSTT-it. Tani, sistemi infrastrukturor SCADA\EMS, i Telekomit dhe Matjeve komerciale ofrojnë mundësi shumë më të avansuara për operim të sigurisë së lartë, në baza planifikuese dhe kohë reale, këmbimin e të dhënave midis objekteve elektroenergjetike, TSO-ve fqinje dhe Qendrës Koordinative të Bllokut Rregullues.


Janë bërë edhe shumë veprime të tjera të cilat kanë ndikuar në ngritjen e besueshmërisë së sistemit, të cilat janë dhënë në vijim:

- Lëshimi në operim i Qendrës Dispeçerike Nacionale (KCS) kryesore dhe Qendrës Emergjente (rezervë)

² Shih Tabelën e Indikatorëve Kyç të Performancës së operimit të transmisionit në pikën 2.3.3 të këtij Raporti

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 48 nga 96</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

- Krijimi i kushteve të interkonektimit me fibër optik me TSO-të fqinje për komunikime inter-TSO
- Janë implementuar dy qendra për menaxhimin dhe monitorimin në kohë reale të infrastrukturës telekomunikuese – NMS (Network Management System), kryesore në KCS dhe rezervë në EKCS
- Modernizimi i komunikimit nga njehsorët në NS me RMC
- Montimi i modemave me adaptera për komunikim me F.O
- instalimi i 20 RTU SCADA sistemeve në nënstacione 110 kV/X kV, të cilat së bashku me sistemet ekzistuese të SCADA e furnizojnë me të dhëna sistemin SCADA/EMS
- lëshimi në punë i sistemit SCADA në NS Ferizaj 2 400 kV/110 kV, prodhim i SIEMENS, NS Palaj dhe NS Skënderaj
- është zëvendësuar infrastruktura e vjetër telekomunikuese e cila nuk i ka plotësuar nevojat bashkëkohore të KOSTT si nga aspekti i kapacitetit, mbulueshmërisë gjeografike, ashtu edhe të besueshmërisë dhe serviseve të ofruara
- është krijuar një infrastrukturë më unike, e cila më lehtë interkonektohet dhe menaxhohet
- janë lidhë pothuajse të gjitha objektet elektroenergjetike 400kV, 220kV dhe 110kV në rrjetin „backbone“ fibër optike
- me implementimin e pajisjeve telekomunikuese SDH, janë realizuar 4 unaza SDH „backbone“ me siguri të dyfishtë (ring protection), për të siguruar rrjedhjen e informatave edhe në raste të defekteve të njëfishta
- siguria e dyfishtë e rrugëve komunikuese ngritë besueshmërinë e funksionimit të nënsistemeve:SCADA/EMS, matjet e tensionit të lartë (HVM), mbrojtja nga distanca (teleprotection)
- më ngritjen e besueshmërisë së nënsistemeve të lartpërmendura ngritet besueshmëria e operimit me sistemin e transmisionit në KOSTT
- me ndihmën e interfejseve (ndërlidhjeve)TCP/IP dhe rrjeteve ethernet, është mundësuar integrimi HVM në rrjetet lokale të KOSTT, duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (GSM) dhe njëkohësisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre
- me ndihmën e interfejseve TCP/IP, rrjeteve ethernet dhe centralit telefonik IP, është mundësuar gjithashtu integrimi i gadi të gjitha objekteve elektroenergjetike në rrjetin lokal telefonik të KOSTT – VOIP (Voice over IP), duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (PTK) dhe njëkohësisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre
- testimi periodik i sistemeve matëse dhe matja e gabimit të tyre
- përshtatja e sistemeve matëse me Kodin e Matjeve
- mirëmbajtja dhe kontrollimi i njehsorëve dhe i pajisjeve për grumbullimin dhe dërgimin e të dhënave në Qendër Grumbulluese (RMC)
- administrimi dhe Operimi me RMC (Remote Metering Center), kalkulimi dhe analiza e humbjeve të energjisë elektrike në transmision.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 49 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Gjatë vitit 2011, janë realizuar projekte të rëndësishme të cilat kanë kontribuar në ofrimin e shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit.

Po cekim disa prej tyre:

- Janë bërë energjizimet e NS Ferizaj 2 400/110/10kV, NS Skenderaj 110/10kV, NS Palaj 110/35/10kV duke përfshirë komisionimin dhe testimin e mbrojtjeve rele.
- Ka filluar implementimi i projektit "Instalimi i pajisjeve të tensionit të lartë në NS Kosova B 400kV në pesë (5) fusha -ana 400 kV
- është bërë aktivizimi i mbrojtjes rele në linjën 179/1 NS Prizreni 1- NS Prizreni 3, përkatësisht vendosja e modulit të furnizimit DC 24/16V

Janë ndërmarrë shumë aktivitete në implementimin e projekteve të reja dhe përfundimin e projekteve në vazhdim, implementimi i suksesshëm i të cilave do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të vendosura nga KOSTT, të cilat janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat teknike që dalin nga ENTSO-E.


Investimet në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimi i sistemit dhe mirëmbajtja preventive, kanë ndikuar në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit gjë që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

Zhvillimet momentale në sektorin e energjisë (procesi drejt privatizimit të rrjetit të shpërndarjes dhe furnizimit, nxitja e investitorëve për investime në projektin Kosova e Re) kërkojnë kalimin nga faza ekzistuese e modelit të tregut në një fazë tjetër, si dhe dizajnimin e një tregu të energjisë elektrike të përshtatshëm për investimet në sektorin e energjisë elektrike, i cili do të jetë në harmoni me kërkesat që dalin nga TKE. Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është menduar të zhvillohet nëpër disa faza, varësisht nga zhvillimi dhe reformimi i sektorit të energjisë elektrike në Kosovë dhe zhvillimeve në tregun rajonal. Operatori i Tregut, pas miratimit të dizjnit të tregut i cili i është dërguar ZRrE-së për miratim, do të bëjë modifikimin e Rregullave të Tregut në harmoni me dizajnin e miratuar, në mënyrë që tu mundësojë palëve pjesëmarrëse kushte jo diskriminuese për tregtim të energjisë elektrike.

Poashtu, është bërë porositja dhe instalimi i TI-së së tregut, që pritet të lëshohet në funksion gjatë vitit 2012.

Kryerja e obligimeve me kohë ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës, dëshmon më së miri për arritjen e synimit të KOSTT që të jetë një kompani financiarisht e qëndrueshme.

Njëra nga objektivat strategjike të definuara në Planin e Biznesit të KOSTT, është përkujdesja për shëndetin e punëtorëve të saj. Për këtë qëllim, KOSTT ka realizuar projektin e sigurimit shëndetësor për të gjithë punëtorët me mjete buxhetore të kompanisë. Sigurimi shëndetësor do të ndikojë në motivimin e punëtorëve për punë dhe me këtë, KOSTT do ta përmbushë objektivën strategjike, për të qenë punëdhënës atraktiv.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 50 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Në harmoni me objektivin e përgjegjshmërisë nga aspekti social, KOSTT ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë për punëtorët e saj, duke i siguruar kushtet e mira të punës në bazë të standardeve më të larta. Po përmendim këtu renovimet e ndërtesës, masat e ndërmarra për parandalimin e rreziqeve në punë dhe paisjet mbrojtëse në punë. Përgjegjësinë e saj nga aspekti social, KOSTT e ka dëshmuar edhe duke ofruar mbështetje financiare për shkollim, duke siguruar 10 bursa për studentë.

Për të qenë një punëdhënës atraktiv dhe për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të performancës në punë, KOSTT ka investuar në zhvillimin profesional të punëtorëve me realizimin e trajnimeve, pjesëmarrjen në seminare, workshope dhe grupe punuese. Nuk ka munguar as përkrahja për përgatitjen dhe publikimin e punimeve shkencore të punëtorëve të KOSTT, të cilët kanë publikuar punimet e tyre shkencore në revista prestigjioze; sigurimi i literaturës së nevojshme profesionale, etj.


KOSTT njihet si prioritetin e lartë që duhet ta ketë mbrojtja e mjedisit në Kosovë dhe më gjërë. Poashtu, duke pasqyruar se një nga objektivat e kompanisë është edhe përgjegjësia në aspektin mjedisor, KOSTT ka treguar një përkushtim të vazhdueshëm duke investuar në mbjelljen e gjelbrimit, pastrimin e objekteve dhe ambientit, eliminimin e hekurishteve dhe materialeve të papërdorshme dhe të rrezikshme për shëndetin (skrab) nga objektet ekzistuese.

Falë angazhimit dhe profesionalizmit të të gjithë punëtorëve, KOSTT ka vazhduar të dëshmojë përpikëri në zbatimin e standardeve më të larta profesionale. Është fjala për certifikimin për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008, me të cilën KOSTT u bë ndërmarrja e parë publike në Kosovë, e certifikuar me këtë standard.

Në veprimtarinë e përditshme të KOSTT, vend të veçantë zënë marrëdhëniet efektive me palët e interesit, e që njëkohësisht paraqesin një nga objektivat e saj strategjike. Prandaj, KOSTT edhe në vitin 2011 ka vazhduar me ndërtimin dhe zhvillimin e raporteve korrekte, në rradhë të parë me aksionarët (Qeverinë e Kosovës), me palët e interesuara e posaçërisht me ZRRë, donatorët (Komisioni Evropian, KfW, USAID, etj), OST-të fqinje, përdoruesit dhe më gjërë, por edhe me institucionet financiare relevante.

KOSTT eksiston dhe vepron në rrethinën e vet afariste, prandaj ndryshimet që vijnë nga kjo rrethinë, domosdo, kanë reflektim dhe ndikim edhe në afarizmin e kompanisë.


Situatë e re në rrethinën afariste mund të paraqet iniciativa e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shthurjen dhe privatizimin e rrjetit të shpërndarjes dhe furnizimit të KEK-ut.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 51 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Aktualisht janë bërë të njohura parametrat e privatizimit të shpërndarjes dhe furnizimit, që pritet të realizohet gjatë vitit 2012. KOSTT duhet të bëjë përgatitjet e duhura që të mundësojë qasjen e investitorit të ri në shfrytëzimin e sistemit të transmisionit sipas rregullimeve të cilat do të azhurnohen me kërkesat e ligjeve të reja të energjisë elektrike. Fjala është për kodet teknike sa i përket rrjetit të transmisionit, ndërsa KOSTT gjithashtu duhet të ndërmerr hapat konkrete për operimin e pjestarëve të ri të tregut dhe krijimin e kushteve për qasjen e tyre në tregun e energjisë elektrike.


Sa i përket procesit eventual të privatizimit të kapaciteteve gjeneruese, gjithashtu gjatë vitit 2012 KOSTT duhet të ndërmerr një sërë aktivitetesh që aktualisht janë të lidhura me modelin e tregut të energjisë elektrike dhe rregullat e tregut, që gjithashtu duhet të krijojnë qasjen transparente dhe të pjestarëve të tregut.

Poashtu në rrethinën afariste do të ndikojë kalimi i aseteve të transformatorëve 220/35/10(20) dhe 110 kV, si dhe i fushave përkatëse me ndërprerësit e transformatorëve 35 kV dhe 10 (20) kV nga KEK sh.a në KOSTT, sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës, të datës 03 Gusht 2011.


	RAPORT VJETOR	DI-PB-004
	ver. 1.0	faqe 52 nga 96
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

2.5. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTI


Projekti	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontrates	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	Realizimi: (i.) Progresi, (ii.) rreziku dhe pengesat	Rekomandimet
1 <i>Projekti i Rehabilitimit të NS 220/110 kV – Kosova A</i>	10,334,070.00 €	BK / KfW	9,881,052.73 €	17.12.2007	16.12.2009	Siemens (Arl)	(i.) Projekti ka qenë nën fazën garantuëse njëvjeçare, deri më 27.10.2011. Kontraktuesi deri në kuartalin e kartët (Q4) ka eliminuar vërejtjet konform vërejtjeve të bëra nga komisioni për pranim teknik intern, si dhe ka dorëzuar dokumentacionin përfundimtar sipas realizimit të punëve "as build drawings". Në Nëntor 2011 komisioni edhe njëherë ka dalë në teren për verifikim dhe pas asaj është lëshuar Certifikata e Pranimit Final (FAC), më 27.12.2011. Projekti i është dorëzuar Departamentit për Operim të Transmisionit dhe atij të Operimit të Sistemit, prej datës 27.12.2011.	
2 <i>Paket Projekti i NS 400/110 kV – Peja 3 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 dhe 110 kV</i>	23,343,233,00 €	BK / KfW	21,562,716,00 € (pa taksa)	10.06.2008	15.03.2010	Siemens & Umel (B&H)	(i.) Paket Projekti Peja 3 bashkë me linjat ndërlidhëse të, i cili është realizuar në dy faza: punët e definuar NS 400/110kV Peja 3 me linjat ndërlidhëse ka përfunduar në Nëntor 2010 (përfshirë edhe afatin garantuëse) dhe iu është lëshuar Certifikata e Pranimit Final (FAC/PC-Certifikata e Performancës, sipas termave të FIDIC-ut). Punët opsionale NS 110/10 kV Skenderaj me linjat ndërlidhëse 110 kV, kanë vazhduar gjatë vitit 2011, në momentin e krijimit të kushteve për punë për kontraktuesin, pas zgjedhjes së çështjeve pronësore juridike për ndërtimin a shryllës nr.1. Me 23 Nëntor 2011, NS 110/10(20) kV – Skendraj është lëshuar në punë provuese, me ç rast kontraktuesit i është lëshuar Certifikata e Pranimit të Përkohshëm (PAC/TOC - Takign Over Certificate, sipas kushteve të FIDIC-ut)dhe ka startuar me afatin garantuëse njëvjeçar.	

	RAPORT VJETOR	DI-PB-004
	ver. 1.0	faqe 53 nga 96
Departamenti Financiar		
Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti		


3	<p><i>Shërbime Konsulentësh për Paket Projektin NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 dhe 110 kV</i></p>	700,000.00 €	ECL0	668,500.00 €	17.12.2009	17.10.2011	INGEDIA (Ro)	<p>Gjatë vitit 2011 kontraktuesi ka përmbyllur me liferimin e pjesëve rezervë, liferim të dokumentacionit përfundimtar "as built drawings". Projekti është përmbyllur edhe financiarisht, pasi që "mjete" - Retention Money për pjesën e punëve, që ndërlihen me NS Skenderaj, kontraktuesi ka sjellur garancionin bankar, konform kushteve të kontratës.</p> <p>(i.) Kompania konsulente Ingedia, e angazhar nga Komisioni Europian, për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e paket projektit "NS 400/110kV Ferizaj 2 dhe linjat ndërlidhëse 400 dhe 110 kV, me stafin ndërkombëtar dhe atë lokal, gjatë vitit 2011 ka përcjellur punët në: komentimin/aprovimin e dizajneve bazike për të dy LOT-at (për nënstationin NS Ferizaj 2 si dhe për Linjat LP 400 & 110 kV), ka mbikëqyrur punimet në terren dhe janë dërguar raportet e inspektimit konform kushteve të kontratës. Në bashkëpunim të ngushtë me ekipin menaxhues të projektit nga Departamenti i Menaxhimit të Projekteve & Inxhinierisë, KOSTT ka organizuar takim të javore, mujore si dhe ka përgaditur raportet tremujore mbi realizimin e projektit. Ka marrë pjesë në testimin e pajisjeve në fabrikë (FAT) dhe në terren (SAT), konform kushteve të kontratës. Ka marrë pjesë në inspektimin dhe energjizimin e linjave dhe nënstationit.</p>	Konsulencës i është kërkuar që të përgadis Raportin Final për projektin.
4	<p><i>Paket Projekti Ferizaj-2 LOT-1: NS 400/110 kV Ferizaj 2</i></p>	15,800,000.00 €	BK	13,656,000.00 €	24.12.2009	23.10.2012	SIEMENS (A ⁺)	<p>(i.) Ky projekt është realizuar para kohe (një javë) në krahasim me planin e aprovuar dinamik dhe kushteve të kontratës. Pas aprovimit të dizajneve, implementimit të punëve ndërtimore dhe atyre elektrike, testimit sipas kontratës dhe specifikimit teknik, me datën 17.10.2011 komisioni intern i KOSTT ka inspektuar punët e realizuar dhe me 18.10.2011 ka deklaruar se linjat e përfundura si dhe nënstationi 400/110kV Ferizaj 2 mund të energjizohet. Pra, më 18.10.2011 NS Ferizaj 2 bashkë me linjat ndërlidhëse 400 dhe 110 kV është energjizuar. Kontraktuesit i është lëshuar Certifikata e Pranimimit të Përkoshëm (PAC) më 16.11.2011, me ç'rast prej kësaj date fillon periudha e agancionit një vjeçar. Kontraktuesit Siemens i mbetet që në afat të përmbyll vërejtjet e dhëna nga Komisioni për Pranim Teknik Intern.</p>	Të gjitha vërejtjet e paraqitura nga komisioni për pranim teknik intern duhet të eliminoohen brenda afatit garantues. Kërkohej nga kontraktori Siemens të realizojnë testin "end to end" të lidhshmërisë së sistemit SCADA/EMS (KCS dhe EKCS) dhe SCS në NS Ferizaj 2.

	RAPORTI VJETOR		DI-PB-004
	ver. 1.0		<i>faqe 54 nga 96</i>
Departamenti Financiar			
Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti			

	<p><i>Paket Projekti Ferizaj-2 ILOT-2.LP ndërlydëse 400 dhe 110 kV</i></p>	7,500,000.00 €	ECL0	6,105,000.00 €	31.12.2009	30.10.2011	UMEL (B&H)	<p>(i.) Ky projekt është realizuar para kohe (një javë) në krahasim me planin e aprovuar dinamik dhe kushteve të kontratës. Pas aprovimit të dizajneve, implementimit të punëve ndërtimore dhe atyre elektrike, testimit sipas kontratës dhe specifikimit teknik, me datën 17.10.2011 komisioni intern i KOSTT ka inspektuar punët e realizuar dhe me 18.10.2011 ka deklaruar se linjat e përfundura si dhe nënstationi 400/110kV Ferizaj 2 mund të energjizohet. Linja 110kV Gjilani 5, për të cilën ka pasë probleme të natyrës juridike, problematike kanë qenë shtyllat 71 ,72 dhe 73, është përfunduar me 30.12.2011 dhe projekti në tërësi ka përfunduar. Sistemi i linjave është nën afat garantues.(ii) Gjatë janarit 2012 do të lëshohet edhe certifikata mbi përfundimin e punëve (PAC).</p>	<p>Kontraktori obligohet që vërejtjet e paraqitura nga komisioni intern i KOSTT ti përfundoj në afatit garantues. Sa i përket aspektit financiar projekti përmbillet nga ECL0</p>
5	<p><i>Shtërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërtimit të LP 400kV, Kosovë - Shqipëri</i></p>	1,200,000.00 €	KfW	1,154,620.00 €	24.09.2009	23.05.2010	INTEC (D)	<p>(i.) Pas përgaditje realizimit të matjeve në terren , përgaditjes së specifikimit teknik nga kompania konsulente "intec" e përzgjedhur nga KfW , projekti është tenderuar dhe është në fazën e evaluimit të ofertuesit më të mirë .</p>	
6	<p><i>Shtërbime Konsulentësh për Projektin SCADA/EMS dhe Telekom</i></p>	891,541.00 €	BK	891,541.00 €	15.01.2008	30.10.2010	KEMA (D)	<p>Me 30 .06.2011 konsulencia ka përfunduar punën sa i përket menaxhimit të projektit SCADA/EMS & Telekom. Në shtator kompania konsulente ka dorëzuar Raportin Final dhe bazuar në të është realizuar pagesa e fundit për shërbimet e kryera sipas kontratës. Projekti ka përfunduar.</p>	

 Departamenti Financiar	RAPORT VJETOR ver. 1.0	DT-PB-004 faqe 55 nga 96
	Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	

7	Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekom LOT: I:SCADA/EMS	8,500,000.00 €	BK	7,875,370.00 €	31.12.2008	30.10.2010	Areva/Komtel (F/RKS)	(i) Projekti është realizuar sipas planit dinamik të frezuar të punëve dhe specifikimit teknik. Pas realizimit të trajtimeve, testimave, liferimit dhe instalimit projekti pjesërisht ka përfunduar dhe me 30.06.2011 sistemi SCADA/EMS & telekomi në qendën Dispererike dhe atë emergjent është testuar dhe lëshuar në funksion. Ka përfunduar Periudha e Disponueshmërisë së Sistemit. Certifikata e Pranimit të Pjesërishtëm (parciale) PPAC, është lëshuar nga ana e KOSTT-it, me ç'rast fillon edhe periudha garantuese njëvjeqare, për ato pjesë të projektit. Gjatë kësaj periudhe kontraktuesi duhet të vazhdoj me përfundim të punëve konform kontratës (instalimin e mbrojtjeve rele dhe sistemit komansues dhe monitorues në NS Prizreni 2) dhe në eliminimin e vërejtjeve nga lista e raportit të komisionit për pranim teknik intern të KOSTT-it.(ii). Pengesat janë në raport me interlockingat (bllokadat) nëpër NS 110, ku janë instaluar RTU.	Të gjitha vërejtjet e paraqitura gjatë SAT - testimave dhe vërejtjet që do të paraqiten nga komisioni intern duhet të eliminoohen brenda afatit të paraparë. Kontraktuesi duhet t'i implementojë interlockingat konform kërkesave dhe standardeve për operim të sigurtë të nënstacioneve. Poashru kontraktuesi duhet të bëjë integrimin e fushës së ndërprerës në anën sekondare konform kërkesave të specifikimit teknik/kontratës.
8	LOT 1 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i ATR3 150 MVA në NS Prishtina 4	3,500,000.00 €	KOSTT	2,214,154.00 €	16.06.2009	15.04.2010	B Petrol & Electroputere (RKS/Ro)	(i) Afati i garancionit ka skaduar me 30.08.2011 dhe është lëshuar certifikata finale (FAC). Nuk ka pasur probleme gjatë këtyj viti dhe projekti është dorëzuar Departamentit të Transmisionit.	



Departamenti Financiar

RAPORTI VJETOR


ver. 1.0

DT-PB-004

faqe 56 nga 96

Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Idetifikues	Titulli i Aktivitetit	Tipi i Aktivitetit	Shënimet	Shënimet	Shënimet	Shënimet	Shënimet	Shënimet	Shënimet	Shënimet	Shënimet				
6	<p>LOT 2 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i Pajisjeve të TL në NS Prishtina 4</p> <p>Shtërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 dhe Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) dhe TI për Operatorin e Tregut (LOT2)</p>	ECL	800,000.00 €	10,000,000.00€ (LOT 1,2 dhe 3)	775,202.37 €	24.07.2009	23.02.2010	11.07.2012	634,000.00 €	05.10.2010	11.07.2012	INGEDIA (Ro)	<p>(i) Kompania konsulente Ingedia, e angazhar nga Komisioni Europian, për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e paket projektit Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) dhe TI për Operatorin e Tregut (LOT2). Në bashkëpunim të ngushtë me ekipin menaxhues të projektit nga Departamenti i Menaxhimit të Projekteve & Inxhinierisë, KOSTT ka organizuar takime javore, mujore si dhe ka përgaditur raportet tremujore mbi realizimin e projektit. Ka marrë pjesë në testimin e pajisjeve në fabrikë (FAT) dhe në terren (SAT), konform kushteve të kontratës. Ka marrë pjesë në inspektimin dhe energjizimin e linjave dhe nënstationit. Kompania konsulente INGEDIA me ekipin lokal në kontinuitet po i përcjell dhe mbikëqyrë punët në kuadër të projektit, në bashkëpunim me stafin e KOSTT, ka aprovuar dizajnet ,ka mbikëqyrur punët ndërtimore dhe punët implementuese të projektit.Ka marrë pjesë në testimin e pajisjeve në fabrikë -FAT .Takimet javore dhe mujore janë udhëhequr nga kompania konsulente .</p>	<p>(i) Afati i garancionit ka skaduar me 30.08.2011 dhe është lëshuar certifikata finale (FAC). Nuk ka pasur probleme gjatë këtij viti dhe projekti është dorëzuar Departamentit të Transmisionit.</p>	<p>Konsulencës i është kërkuar që të jetë më e kujdesshme në rishikimin e dizajnit dhe punimeve ndërtimor.</p>
10	<p>Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 dhe Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1)</p>	ECL	6,308,920.00 €	10,01.2011	09.07.2012	10.01.2011	09.07.2012	6,308,920.00 €	10.01.2011	09.07.2012	10.01.2011	KONCAR (Hr)	<p>(i) Gjatë vitit 2011 punët janë realizuar sipas planit dinamik të rifreskuar. Në kuadrin e parë, të dytë dhe të tretë punët janë realizuar dhe menaxhuar sipas metodologjisë së punëve të aprovuar: janë aprovuar dizajnet, janë realizuar testimet e pajisjeve në fabrikë si dhe testimi i autotransformatorit, realizuar trajnimet (pjesërisht), liferimi i pajisjeve është bërë pjesërisht. Punët ndërtimore dhe ato instaluese në terren nuk janë zhvilluar me ndonjë intensitet të shtuar dhe mund të thuhet se vetëm 30% e punëve është realizuar. Punët mbikëqyrjen nga kompania konsulente “ingedia” dhe stafi menaxhues dhe mbikëqyrës i KOSTT-it.</p> <p>(ii) Mos përfundimi i punëve të fazës së parë, brenda afatit të paraparë.</p>	<p>Në mënyrë strikte nga KOSTT është sugjeruar që të angazhohen vetëm nënkontraktues profesional dhe me eksperiencë pasi që natyra e punëve është shumë specifike dhe nën tension. KOSTT ka njoftuar kontraktuesin se nuk mbanë përgjegjësi në</p>	



Departamenti Financiar

RAPORTI VJETOR


ver. 1.0

Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

DI-PB-004

faqe 58 nga 96

11	Ndërrimi i pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Kosova B ana 400 kV	1,550,000.00 €	KOSTI	1,275,280.00 €	03.08.2010	02.08.2011	Siemens-Monting (At/RKS)	(i) Punët në kuadër të këtij projekti janë realizuar sipas planit dinamik të punëve ,me datën 11.10.2011 ka dal komisioni profesional për pranimin teknik të punëve të kryera .Më datën 19.10.2011 është lëshuar Provisional Acceptance Certificate (PAC). Afati garantues fillon prej datës 11.10.2011 dhe zgjatë 12 muaj. Vërejtje e dhëna nga komisioni intern duhet të pëmbyllet gjatë afatit garantues .	
12	Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3	2,389,000.00 €	KOSTI	1,959,800.80€	01.06.2011	20.12.2011	ELSA&UKAB (SI/RKS)	(i),(i) Në kuartalin e parë është përgaditur specifikimi teknik I cili është dorëzuar në prokur për procedurat e mëtejme .Në Qershor 2011 është nënshkruar kontrata dhe është startuar me punët sipas metodologjisë së punëve .Pas përcaktimit të trasesë së linjës ,matjeve gjeodezike të trasesës së linjës ,aprovimit të dizajnit ,kontraktuesi ka sjellë projektet të cilat janë dërguar në Ministrinë e Ambientit dhe Komunitë për marrjen e lejeve për ndëtim (rekonstruktimin) e kësaj linje. Kontraktori ka filluar me demontim tëshpyllave në pjesën ku nuk ka probleme pronësoro juridike por puna është stopuar deri në marrje të lejeve . (ii) Janë shkaktuar vonesa në implementim të projektit për shkak të procedurave të lëshimit të lejeve nga organet kompetente.	Planifikim në I mirë të realizimit të projektit duke e pëfshirë edhe procedurat e mmarrjes së lejeve nga organet kompetente(konform Ligjeve të Kosovës)
13	Kyçja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2)	1,050,000.00 €	KOSTI	1,397,094.32 €	27.06.2011	27.07.2012	UMEL (B&H)	(i). Në kuartalin e parë të vitit 2011 është përgaditur specifikimi teknik dhe është dorëzuar në prokurë për procedura të mëtejme të tenderimit . Kuartali i tretë karakterizohet me nënshkrim të kontratës dhe me startim të punëve fillestare: dizajnimit bazik dhe detale. Nga ana e kontraktuesit janë bërë disa matje gjeodezike dhe është caktuar korridori për trasenë e linjës, është përgaditur laborati për shpronësimin e trasesë së linjës (vendi ku do të ndërtohen shpyllat). Konform këtij laborori dhe dizajnit të aprovuar për ndërtimin e linjës dhe konform ligjeve në fuqi është bërë aplikimi për marrjen e Lejes Urbanistike dhe Lejes Ndërtimore në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit. Kontraktori ka startuar me demontimin e disa pajisjeve të vjetra nga NS Lipjanit -110/35 kV	



RAPORT VJETOR

DT-PB-004


ver. 1.0

faqe 59 nga 96

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

14	<i>Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3</i>	250,000.00 €	KOSTT	168,880.32 €	11.07.2011	02.01.2012	KONCAR-KFT (H)	<p>(ii) Është dërguar dokumentacioni për marrjen e lejes nga Ministria e Ambientit dhe të Mjedisit, pritjet që kur të mirret leja të fillohet me implementimin e projektit. Kjo çështje mund të ndikoj në vonesë të projektit.</p> <p>(i) Pas realizimit të specifikimit teknik dhe procedurave të tenderimit është nënshkruar kontrata dhe kontraktori ka startuar me punë sipas planit dinamik të punëve të aprovuar.</p> <p>Pas aprovimit të dizajneve , realizimit të testimeve të pajisjeve në fabrikë kontraktori ka liferuar dhe instaluar pajisjet në nënstacione konform kontratës .Projekti pritjet të përfundoj në Janar 2012 sipas planit .</p> <p>(ii) Projekti pritjet të ketë vonesa për shkak të mos realizimit të shkyçjeve për instalim dhe testim përfundimtar SAT.</p>	
15	<i>Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese)</i>	150,000.00 €	KOSTT	51,976.60 €	25.09.2011	17.12.2011	ELEGANCA (RKS)	<p>(i) Në kuadrin e parë të vitit 2011 është përgatitur specifikimi teknik dhe është dorëzuar në prokurë për procedura të mëtejme të tenderimit. Kuadrin i tretë karakterizohet me nënshkrim të kontratës dhe me startim të punëve fillestare: aprovimin e dizajnit bazik dhe deral. Punët kanë përfunduar pjesërisht 65 %.</p> <p>(ii) Në linjën 126/4 nuk kanë filluar punët akoma për shkak të mos mundësisë së realizimit të kçyçjeve. Ka vonesa në projekt, për shkak të mosangazhimit të duhur me staf dhe makineri nga ana e kontraktuesit.</p>	
16	<i>Ndarja e zbarrave në dy seksione</i>	150,000.00 €	KOSTT	36,951.57 €	09.08.2011	27.01.2012	UKAB	<p>(i) Gjatë kuadrin të dytë dhe të tretë është përgatitur specifikimi teknik dhe janë kryer procedurat e prokurimit. Është nënshkruar kontrata , projekti është në fazën e fillimit; pergatitjes dhe aprovimit të dizajnit bazë.Për shkak të kushteve atmosferike nuk ka mund të realizohen kçyçjet</p>	



Departamenti Financiar

RAPORT VJETOR


ver. 1.0

DT-PB-004

faqe 60 nga 96

Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

17	Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakov 1- Gjakova 2 dhe rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1	4,000,000.00 €	KOSTT	3,267,253 €	02.12.2011	120 ditë pune	Ukab;ELSA Bohemia Muller.	(i) Në fillim të kuartalit të tretë është dorëzuar specifikimi teknik ne prokur për procedura të mëtejme .Kontrata është nënshkruar UKAB / ELSA. Janë mbajtur takimet fillestare " kick of meeting " ,për përcaktimin e planit të punës . Projekti është në fazën fillestare ,Kontraktori ka për obligim përgatitje e projektit me qëllim të marrjes së lejeve për rikonstruim dhe ndërtim. (ii) vonësa në implementim të projekti	
18	Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetjake në NS 400/220kV Kosova B	250,000.00 €	KOSTT	272,409.00	12.12.2011	20.07.2012 (150 ditë pune)	Monting (RKS)	(i) Në fund të kuartalit të dytë të vitit është dorëzuar specifikimi teknik për procedura të mëtejme dhe kontrata është nënshkruar me MONTING " në fund të kuartalit të katërtë. Është mbajtur takimi I parë, projekti është në fazën e fillimit	
19	Rehabilitimi i pajisjeve të TL 110kV në NS Gjilani 1 dhe NSFerizaji 1	1,150,000.00 €	KOSTT					(i) Është dorëzuar specifikimi teknik në prokurë. Projekti është tenderuar dhe është në proces të vlerësimit të ofertave.	
20	Instalimi i dy fushave te reja te linjave 110kV ne NS PZ 2	600,000.00 €	KOSTT					(i) Është përgaditur specifikimi teknik për dy fusha të reja të linjave 110kV në NS Prizreni 2 dhe është dërguar në prokurë për procedurë të meturjeshme.	

	RAPORT VJETOR		DT-PB-004
	ver. 1.0	<i>faqe 61 nga 96</i>	
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	

Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2011

Nr.	Emri i Projektit	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontrates	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues			Buxheti i planifikuar 2011	Buxheti i realizuar 2011	Pergjindja e realizimit	
							UMEL (B&H)	SIMMENS (At)	INGEDIA (Ro)				
1	<i>Shtërbime Konsulentësh për Paket Projektin NS 400/110 kV - Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 & 110 kV</i>	7,500,000.00 €	ECLIO	6,105,000.00 €	31.12.2009	30.10.2011	UMEL (B&H)	23.10.2012	17.10.2011	11,043,302	7,362,654.36	66.67%	
		15,800,000.00 €	BKK	13,656,000.00 €	24.12.2009			SIMMENS (At)					
		700,000.00 €	ECLIO	668,500.00 €	17.12.2009			INGEDIA (Ro)					



Departamenti Financiar

RAPORTI VJETOR


ver. 1.0

DT-PB-004


faqe 62 nga 96

Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

2	Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) dhe TI për Operatorin e Tregut (LOT2)	10,000,000.00€ (LOT1, 2 &3)		E.C.L.O		634,000.00 €		05.10.2010	11.07.2012	INGEDIA (Ro)	380,286		315,192.17	82.88%
		Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1)	6,308,920.00 €	10.01.2011	09.07.2012	KONCAR (Hr)	982,886							
	TI për Operimin e Tregut (LOT2)	834,287.00 €	10.01.2011	09.01.2012	Siemens (At)									

	RAPORTI VJETOR		DI-PB-004
	ver. 1.0		faqe 63 nga 96
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	

3	Ndërrimi i përcuesit, izolatorëve dhe paisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3	2,389,000.00 €	KOSTT	1,959,800.80€	01.06.2011	20.12.2011	ELSA&UKAB (S/RKS)	587,940	598,368.00	101.77%
4	Kyçja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2)	1,050,000.00 €	KOSTT	1,397,094.32 €	27.06.2011	27.07.2012	UMEL (B&H)	420,000	209,564.20	49.90%
5	Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3	250,000.00 €	KOSTT	168,880.32 €	11.07.2011	02.01.2012	KONCAR-KET (H)	84,440	80,113.95	94.88%



RAPORT VJETOR

DI-PB-004


faqe 64 nga 96

ver. 1.0


Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi, Strategjik dhe Buxheti

6	Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese)	150,000.00 €	KOSTT	51,976.60 €	25.09.2011	17.12.2011	ELEGANCA (RKS)	51,000	0.00	0.00%
7	Ndarja e zbarrave në dy seksione	150,000.00 €	KOSTT	36,951.57 €	09.08.2011	27.01.2012	UKAB	18,476	5,543.00	30.00%
8	Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakov 1-Gjakova 2 dhe rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1	1,500,000.00 €	KOSTT	3,267,253 €	02.12.2011	120 dite pune	Ukab;ELSA;Bohemia Muller.	800,000	490,087.95	61.26%
9	Rehabilitimi i pajisjeve për sbspnzime vjetake në NS 400/220kV Kosova B	250,000.00 €	KOSTT	272,409.00	12.12.2011	20.07.2012 (150 ditë pune)	Monting (RKS)	75,000	0.00	0.00%
10	Rehabilitimi i pajisjeve të TL 110kV në NS Gjilani 1 dhe NSFerizaj 1	1,150,000.00 €	KOSTT					230,000	0.00	0.00%

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 65 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

11	<i>Instalimi i dy fushave te reja te linjave 110kV ne NS PZ 2</i>	600,000.00 €	KOSTT									120,000	82,800.00	69.00%				
12	<i>Bazamenti i ri për autotransformatorin ATR 2, 150 MVA, në NS 220/110 kV - Kosova A</i>											45,000	0.00	0.00%				
13	<i>Sbpronësime për ndërtimin e linjës së dyfishtë 110 kV për Lypjan</i>											150,000	0.00	0.00%				

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 66 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm

Objektivat e vendosura të KOSTT, (të cekura në pikën 2.4. të këtij Raporti) janë objektiva strategjike, që do të thot se edhe gjatë vitit 2012, përpjekjet e KOSTT-it do të jenë të orientuara drejt realizimit të po këtyre objektivave.

Zhvillimet kryesore që do të ndikojnë në veprimtarinë e KOSTT e gjatë vitit 2012, sidomos për operimin e sistemit janë:

- Nevoja për përvehtësim/adaptim në zhvillimet e tregut të Kosovës. Kjo kërkon aftësi shtesë dhe zhvillim të procedurave të reja, konform modelit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe në përputhje me afatet e caktuara kohore. Njëkohësisht kërkohet edukim për përdorimin dhe avansimin e platformave të ndryshme softuerike të cilat mundësojnë aktivitetet e të gjitha entiteteve pjesmarrëse në tregun e energjisë dhe që siguron operim më eficient të sistemit elektrik. Në këtë drejtim, investimi në platforma të ndryshme softuerike është domosdoshmëri dhe njëkohësisht, aftësimi për përdorimin e tyre është obligues
- Eksploatimin maksimal i infrastrukturës për monitorim dhe kontroll të SEE, me qëllim të shfrytëzimit optimal të kapaciteteve transmetuese
- Implementimi dhe azhurnimi i kodeve teknike
- Rritja e bashkëpunimit rajonal, nënshkrimi i marrëveshjeve të interkoneksionit, në përputhje me Ligjin e ri të Energjisë Elektrike dhe Politikave nga Doracaku i ENTSO-E dhe
- Operimi në nivel interkonektiv në përputhje me rregullat e ENTSO-E.

Duke u nisur nga zhvillimet momentale në sektorin e energjisë, e në rradhë të parë procesin drejt privatizimit të rrjetit të shpërndarjes dhe furnizimit, si dhe kalimin nga faza ekzistuese e modelit të tregut në një fazë tjetër, për dizajnimin e një tregu të energjisë elektrike të përshtatshëm për investimet në sektorin e energjisë elektrike, KOSTT-i në kapacitetin e vet si Operator i Tregut, duhet të sigurojë që të jetë plotësisht i integruar në të gjitha komponentët e tregut rajonal. Në veçanti KOSTT-i duhet të përcjellë zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në rajon; të luaj rolin e plotë në vendim marrje për zhvillimin e mekanizmave të tregut, përfshirë modifikimin e rregullave të cilat do të mbështesin modelin aktual të tregut; të përmbushë obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, të merr pjesë plotësisht në të gjitha organizatat relevante rajonale dhe evropiane që kanë të bëjnë me operimin e sistemit dhe tregut; të sigurojë që të gjitha kërkesat e operimit rajonal mund të përmbushen, posaçërisht standardet e ENTSO-E dhe cilitdo pasardhës tjetër të mundshëm; të vendosë marrëdhënie të qëndrueshme me OST-të (Operatorët e Sistemit të Transmisionit) fqinje; të zhvillojë aftësitë e nevojshme për operimin e sistemit dhe tregut në nivel rajonal dhe të planifikojë përforcimin e kapacitetit interkonektiv.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 67 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Në vitin 2012 KOSTT synon aplikimin e sistemit të udhëheqjes me mjedisin dhe certifikimin sipas normës ISO 14001:2004, që janë parakushte për përparim të vazhdueshëm të raporteve ndaj mjedisit. Kjo normë është standardi më i përparuar për udhëheqjen me mjedisin i cili është i zbatueshëm në secilën ndërmarrje e cila dëshiron ta aplikojë, mirëmbajtje dhe pandërprerë ta përmirësojë sistemin e vet të udhëheqjes me mjedisin. Zbatimi i një qasjeje të tillë nga ana e ndërmarrjes, është proces vullnetar.

KOSTT në pajtim me objektivat e saj strategjike, i kushton rëndësi të veçantë përmirësimit të kushteve të punës për punëtorët e vet. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2012 do të investohet edhe më tutje në objekte ndërtimore të cilat ndihmojnë realizimin e këtij objektivi.


Disa nga këto objekte janë: ndërtimi i nënkulmit, shtruarja e trotuareve në NS-të, ndërtimi i rrethojës në Kosovën B, asfaltimi i rrugës së qasjes në NS dhe projekte të tjera, të cilat janë të prezantuara në planin e investimeve për vitin 2012, që janë pjesë e Planit të Biznesit për vitin 2012.

Një nga ndryshimet më të rëndësishme dhe me ndikim që e pret KOSTT-in gjatë vitit 2012 është kalimi i aseteve të transformatorëve 220/35/10(20) dhe 110 kV, si dhe i fushave përkatëse me ndërprerësit e transformatorëve 35 kV dhe 10 (20) kV nga KEK sh.a në KOSTT, sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës, të datës 03 Gusht 2011. Jetësimi i këtij Vendimi do të sjell domosdo edhe rritjen e numrit të punëtorëve dhe të shpenzimeve operative në KOSTT.

Gjatë vitit 2012 planifikohet implementimi i aplikacionit “Udhëheqja dhe Mirëmbajtja e Aseteve” si dhe aplikacione tjera të cilat do t’i ndihmojnë kompanisë në realizimin e objektivave strategjike të përcaktuara.

Planifikohet të bëhet licencimi i të gjithë softuerëve në KOSTT, migrimi i sistemit të TI: nga sistemi operativ MS Windows 2003 në MS Windows 2008; nga MS Windows XP në MS Windows 7; nga MS Office Professional 2003 në MS Office 2010 Professional si dhe integrimi i rrjetit të të gjitha nënstacioneve në rrjet të KOSTT-it. Gjithashtu do të bëhet edhe shtimi i funksionaliteteve të aplikacionit të CAS-it përmes shtimit të moduleve.

Në bazë të objektivave të përcaktuara paraprakisht prioritet do ti jipet përmbushjes së parimeve themelore të KOSTT-it lidhur me mjedisin - duke larguar materialet e rrezikshme për shëndetin nga objektet ekzistuese, efikasitetin e energjisë – duke përdorur materiale termike si dhe krijimin e hapësirave të reja për punë duke e realizuar projektin e Fasadës së Ndërtesës Administrative, duke vazhduar me krijimin e hapësirave të gjelbëruara në NS si dhe me përkujdesjen ndaj ambientit të punës në tërësi.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 68 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.7. Rreziqet

Me që ndikimet që vijnë nga jasht, respektivisht nga rrethina afariste, kanë implikimet e tyre në veprimtarinë e KOSTT, janë analizuar dhe identifikuar disa nga rreziqet e mundshme, që janë dhënë në vazhdim.

Të tilla janë pengesat e integritit të KOSTT-it në proceset rajonale, të motivuara politikisht dhe pengesat e vazhdueshme në të cilat KOSTT hasë vite me rradhë, e që vijnë nga EMS.


Nga ana tjetër, kërcënimet financiare janë veçanërisht të rëndësishme dhe mund të marrin formën e vështirësive të inkasimit të të hyrave (ashtu si edhe po ndodhë aktualisht me KEK-un), të të hyrave të lejuara të pamjaftueshme për investime kapitale

Risku rregullator- politik, si moslejimi i rritjes së të hyrave, poashtu është në mesin e rreziqeve potenciale për KOSTT-in.

Një rrezik që duhet pasë parasysh me të cilin sot po ballafaqohet një pjesë e madhe e botës është edhe kriza globale.

Në mënyrë që të ulet ndikimi në secilin rrezik, duhet ndërmirren veprimet:

- Vazhdimi i aktiviteteve rreth evitimit të pengesave nga EPS dhe anëtarësimi sa më shpejt që është i mundur në ENTSO-E;
- Ndërrimi i regjimit të operimit të rregullimit të sistemit nga ai i Serbisë në atë vetjak dhe në bashkëpunim me Shqipërinë;
- Marrja e masave juridike për eliminimin e rreziqeve të arkëtimit të hyrave;
- Avancimi i operimit i sistemit të transmisionit që i paraprinë me aftësinë e sistemit elektrik të akomodojë kërkesat e shfrytëzuesve të sistemit duke ofruar shërbime të kualitetit të lartë, posaçërisht ndaj investitorëve privat të gjenerimit dhe furnizimit dhe shpërndarjes;
- Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit duke sqaruar avantazhet e tregut të energjisë elektrike;
- Implementimi eficient i investimeve kapitale të KOSTT-it

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 69 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Aneks

1. Sponzorimet dhe donacionet

Gjatë vitit 2011 KOSTT ka sponsoruar Fondin Kosovar-Amerikan për edukim (KAEF) në vlerë prej 5,000 euro, përmes Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë ka kontribuar në vlerë prej 10,000 euro në Fondin e Bursave për AUK dhe ka mbështetur financiarisht hapjen e një ekspozite të një nxënësje në vlerë prej 550 euro.

Vlera totale e sponzorimeve është 15,550 euro.

2. Raportet e auditorit të brendshëm


Raporti përfshinë aktivitetet audite të kryera nga Auditori i Brendshëm gjatë vitit 2011, ku këto aktivitete dhe objektiva të zhvilluara nga ZAB janë kryer në bazë të planit vjetor për auditim të brendshëm.

Në vijim janë dhënë disa prej objektivave dhe aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Zyrtari për Auditim të Brendshëm:

- Shkalla e menaxhimit mbi funksionimin e kontrollës së brendshme
- Shkalla e implementimit të planeve vjetore për investimet dhe aktivitet tjera me ndikim material të zhvilluara në Ndërmarrje
- Shkalla e zbatueshmërisë së ligjeve, politikave, procedurave dhe rregullave përkatëse
- Menaxhimi dhe vlerësimi i rrezikut nga menaxhmenti
- Forma e zbatimit të sistemit të pajtueshmërisë
- Shkalla e zbatueshmërisë së planifikimeve buxhetore, biznesor, strategjike etj.
- Auditimi i sferave sistemeve me rrezikshmëri më të lartë
- Auditimi mbi krahasueshmërinë dhe formën e shpenzimeve të planifikuara me ato të realizuar
- Shkalla e besueshmërisë së informatave të ndodhura me ato të prezantuara
- Shkalla e besueshmërisë së evidencave kontabël
- Shpenzimet, të hyrat, dhe investimet kapitale a janë postuar në mënyre të drejtë dhe të saktë në librat kontabël
- Shkalla e përfshirjes së informacioneve të nevojshme që duhet të jenë në përgatitjen e bilanceve vjetore dhe afatgjata të energjisë.

Gjatë vitit 2011 janë lëshuar 5 raporte për 6 departamente të audituara, të cilat paraqiten në vijim:

1. Departamentin e Operimit Transmisionit (Sektori i Automjeteve)


	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 70 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Spektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2. Departamenti i Burimeve Njerëzore
3. Departamentin për Financa
4. Departamentet e Operimit të Sistemit dhe Departamentin e Operimit të Tregut
5. Departamentin e Prokurimit;

Në kuadër të këtyre departamenteve për aktivitete audituese janë përfshirë 15 sektorë të cilët janë përzgjedhur në bazë të detyrave dhe përgjegjësive me ndikim më të lartë në sistemin menaxhues.

Gjate auditimit janë testuar, ekzaminuar çështjet me ndikim më të lartë, ku në varshmëri të procesit të auditimit janë dhënë edhe këshilla gojore të ndryshme varësisht nga natyra e kërkesave të personelit përkatës.

Në raporte të auditimit janë dhënë gjithsej 54 rekomandime, ku në varshmëri me procesin auditues janë përdorur teste monitoruese mbi shkallën e implementimit të këtyre rekomandimeve.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	ver. 1.0	faqe 71 nga 96
Departamenti Financiar		
Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti		

3. Formulimi i vetvlerësimit të Bordit të Drejtorëve

	Vetë-vlerësimi i Bordit	Komenti
A. Aktivitetet e Bordit		
1. Kur ka filluar aktivitetin Bordi, gjegjësisht kur është mbajtur mbledhja e parë e Bordit?	Mbledhja e parë e Bordit është mbajtur me 2 Qershor 2009	
2. Sa anëtarë ka Bordi i Drejtorëve duke përfshirë edhe Kryeshëfin Ekzekutiv të NP?	Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka pasur 7 anëtarë të Bordit. Ndërkohë një anëtar i Bordit ka ndërruar jetë dhe Bordi ka mbetur me 6 anëtarë	
3. Sa mbledhje ka mbajtur Bordi i Drejtorëve gjatë këtij viti?	9 (nëntë) mbledhje dhe 1 takim pune	
4. A është takuar Bordi aq shpesh sa janë paraqitur kërkesat për çështjet e NP-ve?	PO. Bordi është takuar aq shpesh sa janë paraqitur kërkesat. Gjatë vitit 2011 Bordi i KOSTT-it është takuar bazuar në Planin e Punës së KOSTT-it dhe nevojat e KOSTT-it. Bordi ka mbajtur 7 mbledhje të irregullta, 2 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 1 takim për vetvlerësim. Bordi gjatë vitit 2011 është takuar gjithsejtë 10 herë.	
5. A kanë punuar anëtarët e Bordit në mënyrë efikase si ekip, për t'i zgjidhur në mënyrë të kënaqshme mospajtimet?	PO. Bordi ka punuar në mënyrë efikase si ekip. Të gjitha çështjet e diskutimit gjatë mbledhjeve janë harmonizuar dhe Bordi ka vendosur në mënyrë unanime.	



Departamenti Financiar

RAPORT VJETOR


ver. 1.0

DI-PB-004

faqe 72 nga 96

Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

